Devoll Hydropower Sha
Raporti i Audituesit të Pavarur dhe
Pasqyrat Financiare më dhe
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

Përmbajtja

	Faqe
Raporti i audituesit të pavarur	i
Pasqyrat financiare	
Pasqyra e pozicionit financiar	1
Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse	2
Pasqyra e ndryshimeve në kapital	3
Pasqyra e flukseve të mjeteve monetare	4
Shënime shpjeguese mbi pasqyrat financiare	5 - 34

Deloitte Audit Albania Shpk
Rruga Faik Konica, Ndërtesa nr. 6 Hyrja nr 7,
1010, Tirana, Albania
Tel: +355 4 45 17 920
Fax: +355 4 45 17 990
www.deloitte.com/al

RAPORTI I AUDITUESIT TE PAVARUR

Aksionarit dhe Drejtimit të Devoll Hydropower Sha,

Opinioni

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Devoll Hydropower sha ("Shoqëria"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2021 dhe pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, si edhe nga një përmbledhje e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe shënime të tjera shpjeguese.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më 31 dhjetor 2021 si edhe të performancës së saj financiare dhe flukset monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF").

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ("SNA"-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në paragrafin e emërtuar "Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare" të këtij raporti. Ne shprehim pavarësinë tonë nga Shoqëria në përputhje me Kodin Ndërkombëtar të Etikës së Kontabilistëve Profesionistë i vendosur nga Bordi i Kontabilistëve për Standardet Ndërkombëtare të Etikës (përfshirë Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë) (kodi "BKSNE") dhe me kërkesat etike të aplikueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, si edhe, kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me kodin BKSNE.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të mbështetur bazën për opinionin tonë të auditimit.

Informacione të tjera

Drejtimi është përgjegjës për informacionet e tjera. Informacionet e tjera përfshijnë informacionet që paraqiten në raportin vjetor, përgatitur nga Drejtimi në përputhje me Nenet 17 dh 19 të Ligjit nr. 25/2018 datuar 10 maj 2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar, por nuk përfshin pasqyrat financiare dhe raportin tonë të audituesit mbi këto pasqyra. Raporti vjetor parashikohet të na vihet në dispozicion pas datës së këtij raporti të audituesit të pavarur. Opinioni ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim asnjë lloj opinioni në lidhje me këto informacione.

Në lidhje me auditimin e pasqyrave financiare, ne kemi përgjegjësinë të lexojmë informacionet e tjera, të identifikuara më lart kur ato të na vihen në dispozicion dhe të vlerësojmë nëse këto informacione kanë pasaktësi materiale me pasqyrat financiare, apo me njohjen që ne kemi marrë gjatë auditimit ose përndryshe, nëse duket se ato janë me anomali materiale. Pasi të lexojmë raportin vjetor, nëse arrijmë në përfundimin se në të ka një anomali materiale, atëherë ne duhet të komunikojmë për këtë çështje me personat e ngarkuar me qeverisjen.

Deloitte refers to one or more of Deloitte Touche Tohmatsu Limited, a UK private company limited by guarantee, and its network of member firms, each of which is a legally separate and independent entity. Please see http://www.deloitte.com/al/about for a detailed description of the legal structure of Deloitte Touche Tohmatsu Limited and its member firms.

©2022 Deloitte Audit Albania

Përgjegjësitë e drejtimit dhe palëve të ngarkuara me qeverisjen për pasqyrat financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, si edhe për sistemin e kontrollit të brendshëm, i cili në masën që përcaktohet nga drejtimi, është i nevojshëm për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, të paraqesë në shënimet shpjeguese, nëse është e aplikueshme, çështje që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të Shoqërisë, dhe të përdorë parimin kontabël të vijimësisë, përveç rasteve kur drejtimi ka ose për qëllim të likuidojë aktivitetin, ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale, përveç se sa më lart.

Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësia e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimeve apo gabimeve, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë procesit të auditimit. Gjithashtu, ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, hartojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse në përgjigje të këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidenca të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale, si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të sistemeve të kontrolleve të brendshme të aplikueshme për procesin e auditimit me qëllim hartimin e proçedurave të auditimit të përshtatshme me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e sistemeve të kontrolleve të brendshme të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyetueshmërinë, e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen e shënimeve shpjeguese përkatëse të hartuara nga drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë të përdorur nga drejtimi, dhe bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston, atëherë mund të shkaktojë dyshime të rëndësishme mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi. Në rast se ne arrijmë në konkluzionin që një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vemendjen në raportin tonë të auditimit me referencë në shënimin shpjegues përkatës, ose, nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme, ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërprerje të aftësisë së Shoqërisë për vazhduar në vijimësi.

Përgjegjësia e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare (vazhdim)

- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përshirë shënimet shpjeguese dhe nëse pasqyrat financiare prezantojnë transaksionet dhe ngjarjet thelbësore në një mënyrë që arrin prezantimin e drejtë.

Ne komunikojmë me palët e ngarkuara me qeverisjen e Shoqërisë, ku përveç çështjeve të tjera, komunikojmë edhe qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në sistemin e kontrollit të brendshëm që është identifikuar gjatë auditimit tonë.

Deloitte Audit Albania shpk

DELOITTE AUDIT ALBANIA
Ad. Rr. "Faik Konica", Ndertesa Nr. 6, Hyrja Nr.7, 1010 Tirane
TIRANA - ALBANIA
NIPT: L 41709002 H
Tel: 044517920

Deloitte Audit Albania shpk
Rruga "Faik Konica", Ndërtesa Nr.6, Hyrja Nr.7, 1010
Tirana, Albania
Numër unik identifikimi i subjektit (NUIS): L41709002H

Audituesi ligjor
Partner Angazhimi
Enida Cara

Tiranë, Shqipëri
24 mars 2022

Devoll Hydropower Sh.A.
Pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2021
(Të gjitha vlerat janë në Lekë)

	Shënime	Më 31 dhjetor 2021	Më 31 dhjetor 2020
Aktivet			
Prona, makineri dhe pajisje	7	63,909,133,003	65,311,477,157
Aktive jo-materiale	8	13,187,629	19,748,145
Parapagime	9	31,327,795	88,336,969
Derivativë	15	-	157,660,177
Aktiv tatimor i shtyrë	28	2,707,785,872	-
Totali i aktiveve afatgjata		**66,661,434,299**	**65,577,222,448**
Parapagime	9	55,983,620	65,119,307
Derivativë	15	-	78,830,088
Llogari të arkëtueshme dhe të tjera të arkëtueshme	10	3,548,778,077	1,299,776,632
Garanci bankare	11	23,000,000	23,000,000
Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre	12	3,826,713,858	1,073,273,045
Total i aktiveve afatshkurtra		**7,454,475,555**	**2,539,999,072**
Total i aktiveve		**74,115,909,854**	**68,117,221,520**
Kapitali			
Kapitali aksionar	13	86,890,000,000	86,890,000,000
Primi i kapitalit aksionar	14	9,690,000	9,690,000
Humbja e akumuluar		(20,894,518,620)	(21,015,582,041)
Totali i kapitalit		**66,005,171,380**	**65,884,107,959**
Detyrimet			
Derivativë	15	2,125,845,136	380,419,954
Llogari te pagueshme	16	276,645,157	295,657,038
Totali i detyrimeve afatgjata		**2,402,490,293**	**676,076,992**
Detyrime tatimore	28	104,553,983	-
Llogari të pagueshme	16	1,896,145,824	1,307,869,404
Të tjera të pagueshme	17	7,093,022	58,957,188
Derivativë	15	3,700,455,352	190,209,977
Totali i detyrimeve afatshkurtra		**5,708,248,181**	**1,557,036,569**
Totali i detyrimeve		**8,110,738,474**	**2,233,113,561**
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		**74,115,909,854**	**68,117,221,520**

Shënimet shpjeguese në faqet 5 deri më 34 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare janë aprovuar nga Këshilli Mbikëqyrës më 22 Mars 2022 dhe janë nënshkruar për Devoll Hydropower Sha nga:

Rigela Gegprifti
Drejtore Ekzekutiv

Inge Løvåsen
Menaxher i Lartë Financiar

Devoll Hydropower Sh.A.
Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

(Të gjitha vlerat janë në Lekë)

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Të ardhurat	18	8,899,573,168	2,231,919,043
(Humbje)/fitime nga aktivitetet e tregut, neto	19	(4,325,562,174)	265,864,606
Të ardhura të tjera/(shpenzime)	20	9,407,550	(2,333,951)
Blerje energjie	21	(3,782,493,316)	(314,838,707)
Blerje kapacitetesh	22	(513,078,180)	(752,047,089)
Shërbime	23	(1,031,125,572)	(941,339,880)
Kosto personeli	24	(179,763,489)	(93,271,399)
Amortizimi i prona, makineri dhe pajisje	7	(1,393,429,279)	(1,077,573,131)
Amortizimi i aktiveve jo materiale	8	(7,400,700)	(7,649,896)
Shpenzime të tjera	25	(66,241,399)	(64,450,276)
Humbja nga aktiviteti i shfrytëzimit		**(2,390,113,391)**	**(755,720,680)**
(Shpenzimet)/të ardhurat financiare, neto			
(Humbja)/fitimi nga përkthimi në monedhë të huaj, neto	26	(75,289,435)	17,518,418
Humbja financiare, neto	27	(16,660,609)	(6,215,511)
		(91,950,044)	**11,302,907**
Humbja para tatimit		**(2,482,063,435)**	**(744,417,773)**
Tatimi mbi fitimin	28	2,603,126,856	-
Fitimi/(humbja) e vitit		**121,063,421**	**(744,417,773)**
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse		-	-
Totali i te ardhurave gjithëpërfshirëse/(humbjes) për vitin		**121,063,421**	**(744,417,773)**

Shënimet shpjeguese në faqet 5 deri më 34 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Devoll Hydropower Sh.A.
Pasqyra e ndryshimeve në kapital më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021
(Të gjitha vlerat janë në Lekë)

	Kapitali aksionar	Primi i kapitalit aksionar	Humbja e akumuluar	Totali
Teprica më 1 janar 2020	**86,890,000,000**	**9,690,000**	**(20,271,164,268)**	**66,628,525,732**
Humbja e vitit	-	-	(744,417,773)	(744,417,773)
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	-
Totali i humbjeve gjithëpërfshirëse për vitin	**-**	**-**	**(744,417,773)**	**(744,417,773)**
Teprica më 31 dhjetor 2020	**86,890,000,000**	**9,690,000**	**(21,015,582,041)**	**65,884,107,959**
Fitimi i vitit	-	-	121,063,421	121,063,421
Të tjera të ardhura gjithëpërfshirëse	-	-		
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin	**-**	**-**	**121,063,421**	**121,063,421**
Teprica më 31 dhjetor 2021	**86,890,000,000**	**9,690,000**	**(20,894,518,620)**	**66,005,171,380**

Shënimet shpjeguese në faqet 5 deri më 34 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Devoll Hydropower Sh.A.
Pasqyra e flukseve monetare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021
(Të gjitha vlerat janë në Lekë)

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Aktivitetet e shfrytëzimit			
Fitimi/(humbja) para tatimit		121,063,421	(744,417,773)
Rregullime për:			
Amortizimi për prona, makineri dhe pajisje		1,393,429,279	1,077,573,131
Amortizimi për aktive jo materiale		7,400,700	7,649,896
Fitimi/(humbja) nga nxjerrja jashtë përdorimit e aktiveve afatgjata	25	(9,407,550)	2,333,951
Humbje të parealizuara neto nga përkthimi i monedhave të huaja		35,399,769	43,436,944
Humbje të parealizuara nga aktivitetet tregtare, neto	19	5,541,201,817	185,483,666
Të ardhura nga interesi	27	-	(14,573)
Shpenzime interesi	27	16,660,609	6,230,084
Tatimi mbi fitimin		(2,603,126,856)	-
		4,502,621,189	**578,275,326**
Ndryshime në:			
Parapagime	9	10,651,229	(783,121)
Llogari të arkëtueshme dhe të tjera të arkëtueshme	10	(2,119,286,099)	(713,895,928)
Derivativë	15	(49,040,995)	148,656,000
Llogaritë e pagueshme	16	660,184,972	249,054,187
Të tjera të pagueshme	17	(51,864,166)	(17,889,046)
Flukset monetare nga aktivitetet operative		***2,953,266,130***	***243,417,418***
Interesa të arkëtuara		-	14,573
Interesa të paguara		(16,660,609)	(6,230,084)
Flukset monetare nga aktivitetet e shfrytëzimit		**2,936,605,521**	**237,201,907**
Aktivitetet investuese			
Shitja e pronave, makinerive dhe pajisjeve		17,550,585	-
Blerja e pronave, makinerive dhe pajisjeve dhe aktiveve jo materiale		(164,531,742)	(4,828,777,422)
Ndryshime në parapagime	9	55,388,599	414,658,912
Flukset monetare të përdorura në aktivitetet investuese		**(91,592,558)**	**(4,414,118,510)**
Ndryshimi neto i mjeteve monetare dhe ekuivalenteve të tyre		2,845,012,963	(4,176,916,603)
Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre në fillim të vitit		**1,073,273,045**	**5,234,337,996**
Efekti i luhatjes së kursit të këmbimit në mjetet monetare të mbajtura në monedhë të huaj		(91,572,150)	15,851,652
Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre në fund të vitit	**12**	**3,826,713,858**	**1,073,273,045**

Shënimet shpjeguese në faqet 5 deri më 34 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. Të përgjithshme

Informacion i përgjithshëm mbi Shoqërinë

Devoll Hydropower Sh.A. ("Shoqëria") është themeluar në Shqipëri. Adresa e regjistruar e Shoqërisë është në Rruga "Papa Gjon Pali II", ABA Business Center, Zyra Nr.1206, Tiranë. Devoll Hydropower Sh.A. është regjistruar në datën 18 Dhjetor 2008 në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), me NIPT K82418002C dhe aktualisht raporton pranë Drejtorisë Tatimore te Tatimpaguesve te Mëdhenj Tiranë.

Shoqëria është themeluar fillimisht si shoqëri koncesionare nga EVN AG dhe Statkraft AS dhe u përfshi në një marrëveshje koncesionare BOOT me objekt ndërtimin dhe shfrytëzimin e Hidrocentraleve në lumin Devoll, me vendndodhje në pjesën e mesme dhe të sipërme të luginës së lumit Devoll, midis komunave Maliq dhe Banjë. Devoll Hydropower Sh.A bashkë me EVN AG dhe Statkraft AS u shpallën fitues të marrëveshjes koncesionare, bazuar në Ligjin nr. 10083 të datës 23 shkurt 2009.

Pas transferimit të aksioneve nga EVN AG dhe Statkraft A.S. gjatë viteve 2013 dhe 2014 Statkraft Markets B.V. është aksionari i vetëm i Devoll Hydropower Sh.A ("Shoqëria mëmë").

Drejtuesit e Shoqërisë

Anëtarët e Këshillit mbikëqyrës dhe afatet përkatëse të emërimit janë si vijon:

Anëtari	Afati i emërimit
Tima Iver Utne, Kryetar	Deri më 31/03/2024
Wenche Lund Oyno	Deri më 30/09/2022
Olav Holland	Deri më 06/02/2025

Drejtore ekzekutive është Znj. Rigela Gegprifti.

Marrëveshja Koncesionare - kushte të rëndësishme

Sipas nenit 78 dhe 83 të Kushtetutës së Shqipërisë dhe Ligjit nr. 9663 "Për koncesionet" i datës 18 dhjetor 2006, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 463 "Mbi aprovimin e autoritetit kontraktues për dhënien e koncensionit për hidrocentralet në kaskadën e lumit Devoll dhe aprovimin e bonusit në procedurën për përzgjedhjen e ofertës së Shoqërisë" i datës 18.07.2007, Parlamenti i Shqipërisë miratoi ligjin nr. 10083 "Mbi aprovimin e Marrëveshjes Koncesionare ndërmjet METE (aktualisht Ministria e Energjisë dhe Industrisë – MEI) dhe EVN AG, STATKRAFT AS dhe DEVOLL HYDROPOWER SH.A., si Shoqëria koncesionare për planifikimin, financimin, ndërtimin, pronësinë, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e projektit hidroenergjetik mbi lumin Devoll në Republikën e Shqipërisë" më datë 23.02.2009 ("Marrëveshja Koncesionare") e ndryshuar me Ligj nr. 10037 datë 21.10.2010 "Për një shtesë në Ligjin nr. 10083 datë 23.02.2009", me Ligj nr. 105/2013 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 10083 datë 23.02.2009" dhe me Ligj nr. 7/2015 "Për një ndryshim dhe shtesë në ligjin nr. 10083, datë 23.2.2009".

Sipas Marrëveshjes Koncesionare dhe ndryshimeve përkatëse, Shoqëria do të ndërtojë të paktën dy njësi prodhuese hidroenergjetike (Moglicë dhe Banja) me një kapacitet total rreth 256 MW dhe me një prodhim mesatar rreth 700 GWh në vit energji të ri-përtëritshme dhe të pastër.

Koncesioni për hidrocentralet përfshin planifikimin, ndërtimin, financimin, pronësinë, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e të paktën dy hidrocentraleve të vendosura në pjesën e mesme dhe të sipërme të luginës së lumit Devoll. Në përputhje me koncesionin për hidrocentralin, trualli i ndërtimit, përdorimi i ujit të luginës së lumit Devoll ndërmjet lartësive 95-650 metra mbi nivelin e detit, përfshirë dhe Lumin Devoll dhe degëzimet e tij do ti transferohen Devoll Hydropower Sh.A.

Sipas Marrëveshjes Koncesionare, koncesionari është e lejuar që të furnizojë prodhimin neto të energjisë elektrike brenda ose jashtë Shqipërisë (që do të prodhohet nga Koncesionari). Marrëveshja Koncesionare është organizuar si një model projekti i tipit BOOT (Ndërtim-Zotërim-Operim-Transferim) dhe do të zgjasë për një Periudhë Fillestare prej 35 vjetësh nga data efektive.

1. Të përgjithshme (vazhdim)

Marrëveshja Koncesionare – kushte të rëndësishme (vazhdim)

Nëse në përfundim të Periudhës Fillestare, as arritja e normës IRR dhe as Ngjarja e Arritjes së Prodhimit nuk kanë ndodhur, Faza Fillestare do të shtyhet automatikisht sipas dispozitave te Marrëveshjes Koncesionare ("Shtyrja e Afatit"). Pas kësaj periudhe, pronësia e hidrocentralit do t'i transferohet MEI (më parë Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjisë – METE) pa asnjë tarifë, bashkë me pajisjet e operimit, të drejtat e garantuara dhe kontratat.

Njësia prodhuese hidroenergjetike Banja ("Banja HPP") filloi aktivitetin tregtar në shtator të vitit 2016. Aktiviteti tregtar i hidrocentralit Banja mbështetet nga licencat e mëposhtme të dhëna nga Enti Shqiptar Rregullator i Energjisë (ERE):

- Licenca për Prodhimin e Energjisë Elektrike Nr. 342, dhënë sipas vendimit të ERE Nr. 80, i datës 9/6/2016 të ERE për një periudhë 30 vjeçare;
- Licenca për Tregtimin e Energjisë Elektrike Nr. 274, dhënë sipas vendimit të ERE Nr. 35, i datës 4/3/2015 të ERE për një periudhë 5 vjeçare;
- Licenca për Furnizimit e Energjisë Elektrike Nr. 343, dhënë sipas vendimit të ERE Nr. 81 i datës 9/6/2016 për një periudhë 5 vjeçare;

2. Bazat e kontabilitetit

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF). Pasqyrat financiare janë autorizuar për lëshim nga Bordi Drejtues më 22 Mars 2022.

Detaje lidhur me politikat kontabël të Shoqërisë gjenden në shënimin shpjegues 6.

3. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë ndërtuar në bazë të parimit të kostos historike duke përjashtuar instrumentet financiare derivative të cilët janë matur me vlerë të drejtë në datën e raportimit.

4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lekë shqiptar ("Lek"), e cila është monedha funksionale dhe e paraqitjes së Shoqërisë.

5. Përdorimi i parashikimeve dhe gjykimeve

Për përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare është kërkuar që drejtimi të bëjë gjykimet, parashikimet dhe supozimet të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet faktike mund të ndryshojnë nga këto parashikime.

Parashikimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e parashikimeve kontabël njihen në mënyrë prospektive.

Drejtimi i ka përgatitur këto pasqyra financiare mbi parimin e vijimësisë. Në kryerjen e këtij gjykimi, Drejtimi mori parasysh pozicionin financiar të Shoqërisë Mëmë, objektivat aktuale, përfitueshmërinë e operacioneve dhe aksesin në burimet financiare dhe ka analizuar ndikimin e krizës më të fundit financiare në operacionet e ardhshme të Shoqërisë Mëmë.

(a) Gjykime

Informacioni lidhur me gjykimet që janë bërë në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë edhe efektet më të rëndësishme në shumat e njohura në pasqyrat financiare paraqitet si më poshtë:

Tatimi mbi fitimin

Shoqëria është subjekt i tatimit mbi fitimin në Shqipëri. Një gjykim i konsiderueshëm kërkohet në përcaktimin e shumës së tatim fitimit të shtyrë. Ka transaksione dhe përllogaritje për të cilat përcaktimi i detyrimit përfundimtar është i pasigurt. Në rast se detyrimet tatimore përfundimtare të këtyre çështjeve janë ndryshe nga vlera me të cilën janë regjistruar në fillim, këto diferenca do të ndikojnë në të drejtat dhe detyrimet e tatim fitimit dhe tatimin e shtyrë aktiv e pasiv të periudhës në të cilën bëhet një përcaktim i tillë. Ju lutemi, ti referoheni shënimit shpjegues 26 "Shpenzimet e tatimit mbi Fitimin".

5. Përdorimi i parashikimeve dhe gjykimeve (vazhdim)

(b) Supozime dhe pasiguritë në parashikime

Informacioni lidhur me pasiguritë në parashikime dhe vlerësime të cilat kanë edhe efektet më të rëndësishme në shumat e njohura në pasqyrat financiare paraqitet si më poshtë:

(i) Jeta e dobishme e prona, makineri dhe pajisje

Siç përshkruhet në shënimin shpjegues 6 (b) (iii), Drejtimi i Shoqërisë rishikon jetën e dobishme të vlerësuar të pronave, makinerive dhe pajisjeve në fund të çdo periudhe raportimi. Gjatë vitit aktual, drejtorët përcaktuan se jeta e dobishme e pronave, makinerive dhe pajisjeve nuk ka ndryshuar. Më poshtë jepet një analizë e efekteve të ndryshimeve në jetën e dobishme të aktiveve afatgjata materiale tek fitimi ose humbja dhe kapitali, duke supozuar se të gjithë variablat e tjerë, në veçanti metodat e zhvlerësimit, mbahen konstante:

	2021	**2020**
Jeta e dobishme rritet me 10%	131,919,119	77,454,416
Jeta e dobishme zvogëlohet me 10%	(164,983,351)	(80,847,139)

(ii) Zhvlerësimi i pronave, makinerive dhe pajisjeve

Gjatë vitit 2021 dhe 2020, drejtim ka gjykuar se nuk ka asnjë tregues të zhvlerësimit të pronave, makinerive dhe pajisjeve si rezultat i testeve të zhvlerësimit.

(iii) Matja me vlerën e drejtë

Disa nga politikat kontabël dhe shënimet shpjeguese të Shoqërisë kërkojnë matjen e vlerës së drejtë, për aktivet dhe detyrimet financiare. Aktivet financiare dhe detyrimet financiare të matura dhe te cilat mbahen me vlerë të drejtë klasifikohen në një nga tre kategoritë, njohur si nivelet e hierarkisë të cilat përcaktohen nga të dhënat që përdoren për të përcaktuar vlerën e drejtë:

- **Niveli 1:** Vlera e drejtë përcaktohet duke përdorur të dhëna të vëzhguara të cilat reflektojë çmime të parregulluara të diktuara nga tregu për aktivet dhe detyrimet te njëjta.
- **Niveli 2:** Vlera e drejtë përcaktohet duke përdorur të dhëna të cilat mund të jenë të dallueshme drejtpërdrejtë ose të dhëna jo të vëzhguara të cilat janë vërtetuar nga të dhënat e tregut.
- **Niveli 3**: Vlera e drejtë përcaktohet duke përdorur të dhëna të rëndësishme jo të vëzhgueshme të cilat nuk janë vërtetuar nga të dhënat e tregut dhe mund të përdoren për të zhvilluar metodologji të brendshme të cilat sjellin vlerësimin më të mirë të drejtimit për vlerën e drejtë.

(c) Vlerësime kritike të kontabilitetit

Më 11 mars 2020, Organizata Botërore e Shëndetësisë shpalli përhapjen e COVID-19, një pandemi globale. Në përgjigje të pandemisë, autoritetet e Qeverisë Shqiptare zbatuan masa të shumta, në përpjekje për të kontrolluar përhapjen dhe efektet e COVID-19, të tilla si ndalime të udhëtimeve dhe kufizime, karantinë, pagesë për punonjësit e larguar nga punëdhënësi, pushime të paguara dhe kufizime në veprimtarinë e biznesit, duke përfshirë mbylljen. Masat e mësipërme u hoqën gradualisht gjatë 2020 dhe 2021. Këto masa përveç të tjerave kanë kufizuar fuqimisht aktivitetin ekonomik në Shqipëri dhe kanë ndikuar negativisht, dhe mund te vazhdojnë të ndikojnë negativisht bizneset, pjesëmarrësit e tregut, bankat si në Shqipëri dhe globalisht për një periudhë të panjohur kohe. Megjithatë, në datën e përgatitjes së këtyre pasqyrave financiare, Shoqëria bazuar në sa më sipër dhe në përputhje gjithashtu me planin financiar të miratuar në vitet e ardhshme, pret të rrisë veprimtarinë operative dhe ka projektuar të arrijë një rezultat pozitiv në vitet e ardhshme.

6. Politika të rëndësishme kontabël

Politikat kontabël të paraqitura më poshtë janë aplikuar në të gjitha periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare dhe në mënyrë të vazhdueshme nga Shoqëria.

(a) Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedha të huaja përkthehen në monedhën funksionale me kursin e datës së transaksionit.

Aktivet dhe detyrimet monetare në monedha të huaja në datën e raportimit përkthehen në monedhën funksionale me kursin e datës së raportimit. Fitimi ose humbja nga kursi i këmbimit për zërat monetare është diferenca ndërmjet kostove të amortizuara në monedhën funksionale në fillim të periudhës dhe kostove të amortizuara në monedhë të huaj të përkthyera me kursin e këmbimit në datën e raportimit (shiko Shënimin shpjegues 29 (b) (iv)).

Zërat jo monetare që maten në bazë të kostos historike në monedhë të huaj, përkthehen duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit.

(b) Prona, makineri dhe pajisje

(i) Njohja dhe matja

Pronat, makineritë dhe pajisjet maten me koston e tyre duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi i akumuluar.

Kostot përfshijnë shpenzimet që janë të lidhura direkt me blerjen e aktivit. Kosto e aktiveve të ndërtuar vetë përfshijë koston e materialeve dhe punës direkte dhe çdo kosto tjetër direkte të lidhur me vënien e aktivit në kushtet e punës për përdorimin e parashikuar, kostot e çmontimit dhe heqjen e pjesëve dhe restaurimin e zonës në të cilat ato janë vendosur dhe kostot e kapitalizuara të huamarrjes (nëse ka). Programi i blerë që është pjesë përbërëse në funksionimin e një pajisjeje është kapitalizuar si pjesë e pajisjes. Kur pjesë të një prone, makinerie dhe pajisjeje kanë jetë-gjatësi të ndryshme, ato llogariten si të ndara (pjesë të rëndësishme) të pronave, makinerive dhe pajisjeve. Fitimet dhe humbjet nga nxjerrja jashtë përdorimit e ndonjë zëri te pronave, makinerive dhe pajisjeve janë përcaktuar duke krahasuar të ardhurat e marra nga nxjerrja jashtë përdorimit me vlerën kontabël neto të pronës, makinerisë dhe pajisjes dhe janë pasqyruar neto në zërin të ardhura të tjera të pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve.

(ii) Kostot vijuese

Kosto e zëvendësimit të një pjese të pronave, makinerive dhe pajisjeve është njohur në vlerën kontabël neto të pjesës, në qoftë se është e mundur që në të ardhmen Shoqëria do të ketë përfitime ekonomike lidhur me atë pjesë dhe kosto mund të matet me besueshmëri. Vlera kontabël neto e pjesës që zëvendësohet, hiqet nga regjistrimet. Kostot e shërbimeve të përditshme të pronave, makinerive dhe pajisjeve njihen në pasqyrën e te ardhurave dhe shpenzimeve kur ato ndodhin.

(iii) Zhvlerësimi

Zhvlerësimi llogaritet për të shpërndarë koston e pronave, makinerive dhe pajisjeve minus vlerën e tyre të mbetur gjatë jetës së dobishme dhe përgjithësisht njihet në të ardhura dhe shpenzime.

Aktivet në proces nuk amortizohen.

Jetët e dobishme, të vlerësuara për disa kategori të pronave, makinerive dhe pajisjeve për periudhën aktuale dhe atë krahasuese, janë si më poshtë:

- Objektet e rregullimit të ujit 40-75 vite
- Turbinat, gjeneratorët 15-40 vite
- Ndërtesa, rrugë, ura dhe kalatë 50-75 vite
- Objektet e rrjetit 50 vite
- Mjete, pajisje dhe mjete transporti
  - Mjete të tjera dhe pajisje 10-40 vite

6. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(b) Prona, makineri dhe pajisje (vazhdim)

(iii) Zhvlerësimi (vazhdim)

Jetët e dobishme të vlerësuara për kategoritë e mëposhtme të pronave, makinerive dhe pajisjeve reflektohen në mënyrë të përafërt nga normat e zhvlerësimit dhe metodat e paraqitura më poshtë për periudhën aktuale dhe atë krahasuese:

- Përmirësime të ambienteve të marra me qira — Vlera e mbetur me 5%
- Mjete, pajisje dhe mjete transporti
  - Pajisje zyre dhe pajisje kompjuterike — Vlera e mbetur me 20 - 25%
  - Automjete — Vlera e mbetur me 20%

Zhvlerësimi i këtyre aktiveve do të fillojë kur ato të jenë të gatshme për përdorim, d.m.th. kur ato të jenë në vendndodhjen dhe kushtet e nevojshme për tu përdorur në mënyrën e synuar nga drejtimi i Shoqërisë.

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlerat e mbetura rishikohen në çdo datë raportimi dhe i nënshtrohen rregullimeve nëse është e nevojshme.

(c) Aktivet jo materiale

(i) Njohja dhe matja

Aktivet jo-materiale të cilat janë blerë nga Shoqëria janë matur me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluara nga zhvlerësimi.

(ii) Kostot vijuese

Kostot vijuese kapitalizohen vetëm kur rrisin përfitimet e ardhshme ekonomike të materializuara në një aktiv specifik me të cilat ato lidhen. Të gjitha shpenzimet e tjera duke përfshirë shpenzimet për emrin e mirë dhe markën, njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve kur ndodhin.

(iii) Amortizimi

Amortizimi llogaritet për të shpërndarë koston e zërave të aktiveve jo materiale minus vlerën e tyre të mbetur gjatë jetës së dobishme dhe përgjithësisht njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Jeta e dobishme e vlerësuar pasqyrohet më përafërsisht nga normat dhe metodat e mëposhtme të amortizimit për periudhën aktuale dhe atë krahasuese:

- Programe kompjuterike — Vlera e mbetur me 25%
- Aktive të tjera jo materiale — 6.67 vite

Metodat e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi dhe i nënshtrohen rregullimeve nëse është e nevojshme.

(d) Instrumentet financiarë

(i) Njohja dhe matja fillestare

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht ne datën e krijimit. Të gjithë aktivet e tjerë financiarë dhe detyrimet e tjera financiare janë njohur fillimisht në datën në të cilën Shoqëria bëhet palë e detyrimeve kontraktuale të instrumentit.

Një aktiv financiar (përveçse kur është një llogari e arkëtueshme pa një komponent të rëndësishëm financues) ose një detyrim financiar matet fillimisht me vlerën e drejtë duke i shtuar, për një zë jo të matur me Vlerën e Drejtë Nëpërmjet Fitimit apo Humbjes (VDNFH), kostot e transaksionit që lidhen direkt me blerjen apo emetimin e tij. Një llogari e arkëtueshme pa një komponent të rëndësishëm financues matet fillimisht me çmimin e transaksionit.

(ii) Klasifikimi dhe matja vijuese

Aktivet financiare

Në njohjen fillestare, një aktiv financiar klasifikohet si i matur me: koston e amortizuar; VDATGJ – investimet ne instrumentet e borxhit; VDATGJ – instrumente të kapitalit; ose VDNFH. Aktivet financiare nuk riklasifikohen pas njohjes së tyre fillestare përveçse kur Shoqëria ndryshon modelin e saj të biznesit për menaxhimin e aktiveve financiare, e në këtë rast të gjithë aktivet financiare të prekura, riklasifikohen në ditën e parë të periudhës së parë raportuese pas ndryshimit të modelit të biznesit.

6. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(d) Instrumentet financiarë (vazhdim)

(ii) Klasifikimi dhe matja vijuese (vazhdim)

Aktivet financiare – Vlerësimi i modelit te biznesit:

Shoqëria kryen një vlerësim të objektivit të modelit të biznesit sipas të cilit mbahet një aktiv financiar. Informacioni i marre parasysh përfshin:

- politikat dhe objektivat e specifikuara dhe zbatimi i këtyre politikave në praktikë. Këto përfshijnë nëse strategjia e drejtimit fokusohet në fitimin e të ardhurave të kontraktuara nga interesi, ruajtjen e një profili të veçantë të normës së interesit, përputhjen e kohëzgjatjes së aktiveve financiare me kohëzgjatjen e çdo detyrimi të lidhur me to ose me daljen e pritshme të flukseve monetare ose realizimin e flukseve monetare nëpërmjet shitjes së aktiveve;
- rreziqet që ndikojnë në performancën e modelit të biznesit (dhe të aktiveve financiare të mbajtura brenda këtij modeli biznesi) dhe se si administrohen këto rreziqe;

Aktivet financiare – Vlerësimi nëse flukset monetare kontraktuale janë vetëm pagesa të principalit dhe interesit:

Për qëllimet e këtij vlerësimi, si 'principal' do të përkufizohet vlera e drejtë e aktivit financiar në njohjen fillestare. 'Interesi' do të përkufizohet si e ardhura për vlerën në kohë të parasë dhe me rrezikun e kreditimit lidhur me shumën e mbetur të principalit gjatë një periudhe të caktuar kohe dhe për çdo kosto apo rrezik tjetër bazik mbi huadhënien (si rreziku i likuiditetit dhe kostove administrative), si dhe një marzh fitimi.

Aktivet financiare – Vlerësimi nëse flukset monetare kontraktuale janë vetëm pagesa të principalit dhe interesit (vazhdim):

Në vlerësimin nëse flukset monetare kontraktuale janë vetëm pagesa principali dhe interesi, Shoqëria merr në konsiderate kushtet kontraktuale të instrumentit. Kjo përfshin vlerësimin nëse aktivi financiar ka një kusht kontraktual që mund të ndryshojë kohëzgjatjen ose shumën e flukseve monetare kontraktuale në mënyrë të tillë që ky kusht nuk do të plotësohet. Në kryerjen e këtij vlerësimi, Shoqëria merr parasysh:

- ngjarje të kushtëzuara që mund të ndryshojnë shumën ose kohën e flukseve monetare;
- kushtet që mund të përshtatin normën e kontraktuar të kuponit, duke përfshirë opsione me normë te ndryshueshme;
- parapagimet dhe opsione zgjatje; dhe
- kushtet që kufizojnë pretendimet e Shoqërisë për flukset monetare nga aktive specifike (si p.sh. karakteristikat "pa rekurs").

Një karakteristikë parapagimi është në përputhje me kushtin e pagesave të kryera vetëm për principal dhe interes nëse shuma e parapaguar, në thelb përfaqëson shuma të papaguara të principalit dhe interesit mbi shumën e mbetur të principalit, e cila mund të përfshijë dhe një kompensim të arsyeshëm shtesë për ndërprerje para kohe të kontratës.

Aktivet financiare – Matja në vazhdim dhe fitimi dhe humbjet;

Aktivet financiare me VDNFH

Derivativët e njohur në pasqyrën e pozicionit financiar shfaqen si zëra të ndarë dhe janë matur në vazhdim me vlerën e drejtë me ndryshimet në vlerë të njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Instrumentet financiare të matura me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit dhe humbjes përfshijnë të mëposhtmet:

- Kontratat e shitjes së energjisë fizike të cilat konsiderohen të jenë të përkthyeshme lehtësisht në mjete monetare dhe të cilat nuk janë për përdorim vetjak.
- Kontratat financiare për të shitur dhe blerë produkte të lidhura me energjinë të klasifikuara si derivativë.

Aktivet financiare matur me koston e amortizuar

Këto aktive janë matur në vijim sipas kostos së amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Kosto e amortizuar është zvogëluar nga humbjet nga zhvlerësimi. Të ardhurat nga interesi, fitimi apo humbja nga kurset e këmbimit dhe zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Çdo fitim ose humbje nga çregjistrimi i aktivit njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

6. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(d) Instrumentet financiarë (vazhdim)

(iii) Çregjistrimi

Aktivet financiare

Shoqëria çregjistron një aktiv financiar kur të drejtat kontraktuale mbi flukset monetare nga aktivi financiar skadojnë, ose në qoftë se ajo transferon të drejtat për të arkëtuar flukset monetare kontraktuale të aktivit financiar në një transaksion në të cilin pothuajse të gjithë rreziqet dhe përfitimet e zotërimit të aktivit financiar transferohen ose në të cilin Shoqëria as nuk transferon as nuk mban të gjithë rreziqet dhe përfitimet e pronësisë dhe as nuk ka kontroll mbi aktivin financiar.

Shoqëria futet në një transaksion kur ajo transferon aktivet të njohura në pasqyrën e pozicionit financiar, por mban të gjithë ose pothuajse të gjithë rreziqet dhe përfitimet e aktivit të transferuar. Në këto raste, aktivet e transferuar nuk çregjistrohen.

Detyrimet financiare

Shoqëria e çregjistron një detyrim financiar kur detyrimet e saj kontraktuale shlyhen, anulohen ose skadojnë. Shoqëria gjithashtu çregjistron një detyrim financiar kur kushtet e tij modifikohen, dhe flukset monetare të detyrimit të modifikuar janë rrënjësisht të ndryshme, dhe në këtë rast njihet me vlerën e drejte, një detyrim i ri financiar bazuar mbi kushtet e ndryshuara.

Në çregjistrimin e një detyrimi financiar, diferenca mes vlerës së mbetur dhe pagesës së kryer (duke përfshirë çdo aktiv jo monetar të transferuar apo detyrim të marrë përsipër) njihet në fitim apo humbje.

(iv) Kompensimi

Aktivet financiare dhe detyrimet financiare kompensohen dhe vlera neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm atëherë, kur Shoqëria ka aktualisht një të drejtë ligjore për të kompensuar vlerat dhe synon ose të shlyejë në bazë neto ose të përfitojë aktivin dhe shlyejë detyrimin në të njëjtën kohë.

(e) Të ardhura nga kontratat me klientët

E ardhura nga prodhimi i energjisë elektrike lidhet me shitjen e energjisë elektrike me një çmim të caktuar. Detyrimi është që të shpërndahet një seri mallrash të dallueshme (energji) dhe çmimi i transaksionit është shuma që Shoqëria pret të marrë, qoftë me çmimin e shitjes në atë moment ose me çmimin e kontratës. Detyrimi realizohet përgjatë kohës, kështu që e ardhura njihet për çdo njësi të shitur me çmimin e transaksionit.

Shoqëria përdor lehtësirat praktike, në bazë të së cilës, e ardhura nga energjia për kontratat e saj njihet në shumën të cilën entiteti ka të drejtë për të faturuar. E drejta për të faturuar energjinë lind kur ajo prodhohet dhe shpërndahet dhe shuma e faturuar do të përputhet drejtpërdrejt me shumën për tu arkëtuar nga klienti.

Të ardhurat njihen në përputhje me SNRF 15 “Të ardhurat nga kontratat me klientët”.

(f) Fitimet nga aktivitetet e tregut, neto

Shoqëria hyn në marrëveshje për shitjen e energjisë me klientët e saj të cilat kanë të bëjnë me shitjen e energjisë me një çmim të fiksuar. Kontratat nuk konsiderohen se përmbushin kërkesat për tu klasifikuar si kontrata të cilat mbahen për shitje normale. Shoqëria i kontabilizon kontratat si derivativë të matura me vlerë të drejtë përmes fitimit dhe humbjes në përputhje me SNRF 9. Në datën e marrëveshjes, Shoqëria shlyen fizikisht kontratën duke shitur energjinë në bursë. Fitimet dhe humbjet konsistojnë në zëra të realizuar dhe të parealizuar dhe prezantohen nën zërin “Fitime nga aktivitetet e tregut, neto” në pasqyrën e fitimit dhe humbjes.

6. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(g) Zhvlerësimi

(i) Aktive financiare jo derivative

Instrumentet financiare

Shoqëria njeh humbje nga zhvlerësimi për HPK-të mbi aktivet financiare të matur me koston e amortizuar. Shoqëria i mat humbjet nga zhvlerësimi në një shumë të barabartë me HPK-të 12 mujore, sepse rreziku kreditor nga mos arkëtimi që pritet të ndodhi gjate jetës së instrumentit financiar nuk është rritur në mënyrë të konsiderueshme nga njohja fillestare.

Në përcaktimin nëse rreziku kreditor i një aktivi financiar është rritur në mënyrë të konsiderueshme nga njohja fillestare apo kur behet matja e HPK-ve, Shoqëria merr parasysh informacion të arsyeshëm dhe të bazuar që është i përshtatshëm dhe është i arritshëm pa kosto apo punë shtesë.

Kjo përfshin informacionin sasior dhe cilësor dhe analizimin, bazuar në përvojën e mëparshme të Shoqërisë e informimin mbi vlerësimin e kreditimit, si dhe informacionin për periudhat e ardhshme.

Shoqëria supozon që rreziku kreditor për një aktiv financiar është rritur konsiderueshëm nëse arkëtimi i tij është me vonesë. Megjithatë, humbja mund të regjistrohet përpara se aktivi/të arkëtueshmet të jenë në vonesë nëse kjo mbështetet nga një informacion i arsyeshëm.

Shoqëria merr parasysh edhe faktorët e mëposhtëm, për të vlerësuar nëse rreziku kreditor i një aktivi financiar është rritur konsiderueshëm:

- ndryshimet në shpërndarjen e kreditimit;
- ndryshimet aktuale ose të pritshme të normës së kredisë; ose
- kushtet që ndikojnë në mënyrë të konsiderueshme aktivitetin e biznesit, flukset monetare të pritshme dhe fitimet nga klientët.

Shoqëria konsideron një aktiv financiar në vështirësi shlyerje kur klienti ka pak mundësi të paguajë detyrimin e tij të plotë ndaj Shoqërisë, pa ndërmarrjen nga Shoqëria të veprimeve si marrja e garancisë (nëse është mbajtur ndonjë).

HPK-te 12 mujore janë pjesa e HPK-ve që rezultojnë nga ngjarjet e mundshme të mospagimit brenda 12 muajve pas datës së raportimit (ose për një periudhe më të shkurtër nëse jeta e pritshme e instrumentit është më pak se 12 muaj).

HPK-të përgjatë jetës janë HPK-të që rezultojnë nga të gjitha ngjarjet e mundshme të mospagimit përgjatë jetës së pritshme të instrumentit financiar. Periudha maksimale e marrë parasysh në vlerësimin e HPK-ve, është periudha maksimale kontraktuale gjatë së cilës Shoqëria është e ekspozuar ndaj rrezikut të kredisë.

Matja e HPK-ve

Humbjet e pritshme të kredisë janë një vlerësim i ponderuar i probabilitetit të humbjeve të kredisë. Humbjet e kredisë janë vlera aktuale e të gjithë mungesave monetare (d.m.th. diferenca mes flukseve monetare për t'ju paguar entitetit sipas kontratës dhe flukseve monetare që Shoqëria pret të arkëtojë). HPK-të janë skontuar me normën efektive të interesit të aktivit financiar.

Aktive financiare me kredit të zhvlerësuar

Në çdo datë raportimi, Shoqëria vlerëson nëse aktivet financiare të matura me koston e amortizuar janë me kredit të zhvlerësuar. Një aktiv financiar është me 'kredit të zhvlerësuar' kur ka ndodhur një ose disa ngjarje që kanë një ndikim negativ në flukset monetare të ardhshme të përllogaritura.

Prova që një aktiv financiar është me kredit të zhvlerësuar, përfshin të dhëna te dallueshme si më poshtë:

- vështirësi e konsiderueshme financiare e klientit;
- një shkelje e kontratës si rasti i një mospagimi;
- mundësia që klienti të falimentoje ose të përfshihet në riorganizime të tjera financiare; ose
- ndryshime rregulluese që do të kenë një ndikim negativ në flukset monetare të debitorit.

6. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(g) Zhvlerësimi (vazhdim)

Prezantimi i zhvlerësimit për HPK-të në pasqyrën e pozicionit financiar

Humbjet nga zhvlerësimi për aktivet financiare të matura me koston e amortizuar zbriten nga vlera kontabël bruto e aktiveve.

Çregjistrimi

Vlera kontabël bruto e një aktivi financiar çregjistrohet kur Shoqëria nuk ka një pritshmëri të arsyeshme për rimarrjen e plotë apo të pjesshme të aktivit financiar. Për klientin e saj te vetëm, Shoqëria kryen një vlerësim mbi momentin dhe shumen e çregjistrimit duke u bazuar nëse ka një pritshmëri te arsyeshme të rimarrjes se tij.

(ii) Aktivet jo- financiare

Në çdo datë raportimi, Shoqëria rishikon vlerat kontabël (neto) të aktiveve të saj jo-financiare për të përcaktuar në qoftë se ka ndonjë tregues zhvlerësimi. Në qoftë se ndonjë tregues i tillë ekziston, atëherë llogaritet vlera e rikuperueshme e aktivit. Për testimin e zhvlerësimit, aktivet grupohen në grupe të vogla aktivesh të cilat gjenerojnë flukse hyrëse monetare nga përdorimi i vazhdueshëm të cilat janë të pavarura nga flukset hyrëse monetare të aktiveve të tjera apo njësive gjeneruese të parasë.

Vlera e rikuperueshme e një aktivi apo njësie gjeneruese të parasë është vlera më e lartë midis vlerës në përdorim dhe vlerës së drejtë minus kostot e shitjes. Vlera në përdorim bazohet në vlerësimin e flukseve të ardhshme monetare të skontuara në vlerën e tyre aktuale, duke përdorur një normë skontimi para tatimit e cila reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqeve specifike për aktivin ose njësinë gjeneruese të parasë.

Humbjet nga zhvlerësimi njihen në qoftë se vlera kontabël e aktivit apo njësisë gjeneruese të parasë është më e lartë se vlera e rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi janë njohur në fitim ose humbje. Humbjet nga zhvlerësimi rimerren vetëm në masën sa vlera kontabël e aktivit nuk e tejkalon vlerën kontabël që do të përcaktohej duke i zbritur amortizimin, nëse nuk do të ishte njohur humbja nga zhvlerësimi.

(h) Përfitimet e punëmarrësve

Kontributet e detyrueshme për sigurime shoqërore

Një plan kontributi i përcaktuar është një plan përfitimi pas periudhës së punësimit sipas të cilit një njësi ekonomike paguan kontribute në shuma fikse në një entitet të veçantë dhe nuk ka asnjë detyrim ligjor apo konstruktiv për të paguar shuma të mëtejshme. Qeveria e Shqipërisë është përgjegjëse për sigurimin e pensioneve në Shqipëri, sipas një plani të përcaktuar të kontributeve të pensionit. Kontributet e Shoqërisë në planin e përcaktuar të kontributeve të pensionit njihen si një shpenzim i përfitimit të punonjësve në pasqyrën e të ardhura dhe shpenzime në periudhat gjatë të cilave kryhen shërbimet nga të punësuarit

(i) Provizionet

Një provizion njihet në qoftë se, si rezultat i ngjarjeve në të kaluarën, Shoqërisë i lind një detyrim aktual ligjor ose konstruktiv i cili mund të parashikohet me siguri dhe është e mundur që të ndodhë një dalje e përfitimeve ekonomike për shlyerjen e këtij detyrimi. Provizionet janë përcaktuar duke aktualizuar flukset e pritshme monetare me një normë skontimi para tatimit që reflekton vlerësimet e tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike të detyrimeve. Skontimi i qëndrueshëm është njohur si kosto financiare.

(j) Pagesat e qirasë

Në fillim të një kontrate, Shoqëria vlerëson nëse kontrata është, ose përmban, një qira. Një kontratë është, ose përmban, një qira nëse jep të drejtën për të kontrolluar përdorimin e një aktivi të identifikuar për një periudhë kohe në këmbim të vlerësimit. Për të vlerësuar nëse një kontratë jep të drejtën për të kontrolluar përdorimin e një aktivi të identifikuar, Shoqëria përdor përkufizimin e qirasë në SNRF 16.

6. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(j) Pagesat e qirasë (vazhdim)

Qiratë afatshkurtra

Shoqëria ka zgjedhur të mos njohë një të drejtë për përdorimit e aktiveve dhe detyrime qiraje për qiratë afatshkurtra. Shoqëria njeh pagesat e qirasë që lidhen me këto qira si një shpenzim në bazë lineare për periudhën e qirasë.

(k) Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga interesat për fondet e depozituara në bankë dhe fitimet nga kurset e këmbimit. Të ardhurat nga interesat njihen kur realizohen duke përdorur metodën e interesit efektiv. Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit, humbjet nga kurset e këmbimit dhe humbjet nga zhvlerësimi të njohura në aktivet financiare. Fitimet dhe humbjet nga përkthimi janë paraqitur neto.

(l) Tatimi mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin përbëhet nga tatimi i periudhës dhe tatimi i shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet në të ardhura ose shpenzime përveç rasteve kur lidhet me zëra të njohur direkt në kapital apo në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse. Interesat dhe gjobat e lidhura me tatimin mbi fitimin, përfshirë trajtimet tatimore të paqarta, trajtohen sipas SNK 37 *Provizionet, Detyrimet e Kushtëzuara dhe Aktivet e Kushtëzuara*.

(i) Tatimi mbi fitimin i periudhës

Tatimi i periudhës përfshin tatimin e pritshëm për t'u paguar apo arkëtuar mbi fitimin e tatueshëm apo humbjen për vitin dhe çdo rregullim të tatimit për t'u paguar apo arkëtuar në lidhje me vitet e kaluara. Shuma e tatimit të periudhës e pagueshme apo e arkëtueshme është vlerësimi më i mirë i shumës së tatimit të pritur për t'u paguar apo arkëtuar i cili reflekton pasiguritë e lidhura me tatimin mbi të ardhurat, nëse ka. Ajo llogaritet duke përdorur normat e tatimeve që kanë hyrë ose do të hyjnë në fuqi deri në datën e raportimit. Aktivi dhe detyrimi tatimor i periudhës kompensohen vetëm nëse përmbushen disa kushte të caktuara.

(ii) Tatimi mbi fitimin i shtyrë

Tatimi i shtyrë njihet në lidhje me diferencat e përkohshme midis vlerave kontabël neto të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime raportimi financiar dhe vlerave të përdorura për qëllime tatimore.

Një aktiv për tatime të shtyra njihet për humbjet e mbartura dhe diferencat e përkohshme të zbritshme deri në masën që është i mundur realizimi i të ardhurave të ardhshme të tatueshme, kundrejt të cilave ato mund të përdoren. Përfitimet e ardhshme tatimore përcaktohen duke u bazuar në rimarrjen e diferencave të përkohshme të zbritshme. Nëse shuma e diferencave të përkohshme të zbritshme nuk është e mjaftueshme për të njohur një aktiv tatimor të shtyrë plotësisht, përfitimet tatimore të ardhshme të rregulluara për rimarrjen e diferencave ekzistuese të përkohshme, do konsiderohen bazuar në planin e biznesit. Aktivet tatimore të shtyra rishikohen në çdo datë raportimi dhe zvogëlohen deri sa të mos jetë më e mundshme të realizohen përfitime tatimore të lidhura me to; zvogëlime të tilla rimerren në momentin që rritet probabiliteti i fitimeve të ardhshme tatimore.

Aktivet për tatime të shtyra të panjohura rivlerësohen në çdo datë raportimi dhe njihen deri në masën që është e mundur që të ketë fitime të ardhshme tatimore kundrejt të cilave ato mund të përdoren. Tatimi i shtyrë matet me normat tatimore që priten të aplikohen për diferencat e përkohshme kur ato të rimerren, duke përdorur normat tatimore që kanë hyrë ose do të hyjnë në fuqi deri në datën e raportimit.

Matja e tatimit të shtyrë reflekton efektet tatimore që do të lindnin nga mënyra se si Shoqëria pret që në fund të periudhës raportuese, të realizojë ose shlyejë vlerën kontabël të aktiveve dhe detyrimeve të saj. Aktivet dhe detyrimet për tatime të shtyra kompensohen vetëm nëse përmbushen disa kushte të caktuara.

6. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

Standarde të reja dhe ndryshime në standardet ekzistuese të publikuara jo në zbatim

Një sërë standardesh të reja janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë pas datës 1 janar 2021 dhe aplikimi i hershëm i tyre është i lejuar; megjithatë, Shoqëria nuk i ka aplikuar më herët standardet e reja apo të ndryshuara në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare. Standardet e ndryshuara dhe interpretimet e mëposhtme nuk pritet të kenë një ndikim te rëndësishëm ne pasqyrat financiare të Shoqërisë.

- Ndryshime të SNRF 16 *Koncesionet e Qirave pas 30 Qershor 2021 lidhur me Covid-19* (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 prill 2021),
- Ndryshime të SNK 37 *Provizionet, Detyrimet e Kushtëzuara dhe Aktivet e Kushtëzuara – Kontratat me kushte rënduese – Kosto e Përmbushjes së Kontratës* (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2022),
- Ndryshime të SNK 16 *Aktivet Afatgjata Materiale – Të ardhurat përpara futjes në përdorim* (në fuqi për periudhat vjetore qe fillojnë pas 1 janar 2022),
- Ndryshime të SNRF 3 *Kombinimet e biznesit – Referuar Kuadrit Konceptual* (në fuqi për periudha vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2022),
- Ndryshime të SNK 1 *Prezantimi i Pasqyrave Financiare – Klasifikimi i Detyrimeve si Afatshkurtër apo Afatgjatë* (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2023),
- SNRF 17 *Kontratat e Sigurimit* dhe ndryshime të SNRF 17 *Kontratat e Sigurimit* (në fuqi për periudha vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2023),
- Ndryshime të SNK 1 dhe Udhezimit praktik te IFRS 2 Dhënia e informacioneve mbi politikat kontabël (ne fuqi per periudhat vjetore qe fillojnë me ose pas 1 janar 2023),
- Ndryshime të SNK 8 *Perkufizimi i Perllogaritjeve Kontabël* (në fuqi për periudha vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2023),
- Ndryshime të SNK 12 *Tatimi i Shtyrë në lidhje më Aktivet dhe Detyrimet e lindura nga një Transaksion i Vetëm* (në fuqi për periudha vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2023),
- Ndryshime të SNRF 10 *Pasqyrat Financiare të Konsoliduara* dhe SNK 28 *Investimet në Sipërmarrjet e Përbashkëta – Shitja ose dhurimi i Aktiveve ndërmjet një Investitori dhe bashkëpunëtorit të tij apo sipërmarrjes së përbashkët* (i disponueshëm për aplikim/datë efektive shtyrë për një kohë të pacaktuar).
- Ndryshime te disa standardeve si pasoje e "Permiresime te SNRF-ve (cikli 2018 – 2020)" si rezultat i projektit te përmirësimeve vjetore te IFRS (IFRS 1, IFRS 9, IFRS 16 dhe SNK 41) kryesisht me qellim te eleminimit te inkonsistencave dhe qartësimit te koncepteve (Ndryshime te IFRS 1, IFRS 9 dhe SNK 41 hyjne ne fuqi per periudhat vjetore qe fillojnë me ose pas 1 janar 2022. Ndryshimi i IFRS 16 lidhet vetëm me nje shembull ilustrues, prandaj nuk përcaktohet nje date efektive.)

7. Prona, makineri dhe pajisje

Pronat, makineritë dhe pajisjet janë të përbëra si vijon:

	Objekte të rregullimit të ujit	Turbina, gjeneratorë	Ndërtesa, rrugë, ura, kalatë	Përmirësi me të ambientev e me qira	Mjete, pajisje dhe mjete transporti	Objektet e rrjetit	Aktive në proces	Totali
Kosto								
Më 1 janar 2020	**13,802,894,145**	**7,503,989,408**	**6,570,265,288**	**85,837,893**	**2,164,168,868**	**210,978,654**	**42,305,916,000**	**72,644,050,256**
Transferime ndërmjet klasave të aktiveve	26,449,607,824	5,959,868,616	9,226,687,004	-	10,641,997	975,507,063	(42,622,312,504)	-
Shtesa	2,014,089,734	580,433,581	644,406,771	-	40,589,105	45,471,145	1,527,932,473	4,852,922,809
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	-	-	(20,741,338)	-	-	(20,741,338)
Më 31 dhjetor 2020	**42,266,591,703**	**14,044,291,605**	**16,441,359,063**	**85,837,893**	**2,194,658,632**	**1,231,956,862**	**1,211,535,969**	**77,476,231,727**
Transferime ndërmjet klasave të aktiveve	725,215,139	158,196,706	245,916,391	-	-	-	(1,129,328,236)	-
Shtesa	-	-	-	-	23,366,601	-	146,732,173	23,366,601
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	-	-	(79,527,509)	-	(164,463,398)	(97,258,734)
Më 31 dhjetor 2021	**42,991,806,842**	**14,202,488,311**	**16,687,275,454**	**85,837,893**	**2,138,497,724**	**1,231,956,862**	**64,476,508**	**77,402,339,594**
Zhvlerësimi i akumuluar								
Më 1 janar 2020	**4,854,238,407**	**2,917,017,163**	**2,147,261,118**	**20,208,399**	**1,122,994,321**	**21,669,835**	**-**	**11,083,389,243**
Zhvlerësimi i vitit	458,976,366	317,801,437	151,252,278	3,218,586	141,912,556	26,856,364	-	1,100,017,587
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	-	-	(18,652,260)	-	-	(18,652,260)
Më 31 dhjetor 2020	**5,313,214,773**	**3,234,818,600**	**2,298,513,396**	**23,426,985**	**1,246,254,617**	**48,526,199**	**-**	**12,164,754,570**
Zhvlerësimi i vitit	632,079,678	388,384,892	199,152,875	3,059,444	138,792,223	38,367,383	-	1,399,836,495
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	-	-	(71,384,474)	-	-	(71,384,474)
Më 31 dhjetor 2021	**5,945,294,451**	**3,623,203,492**	**2,497,666,271**	**26,486,429**	**1,313,662,366**	**86,893,582**	**-**	**13,493,206,591**
Vlera kontabël neto								
Më 1 janar 2020	**8,948,655,738**	**4,586,972,245**	**4,423,004,170**	**65,629,494**	**1,041,174,547**	**189,308,819**	**42,305,916,000**	**61,560,661,013**
Më 31 dhjetor 2020	**36,953,376,930**	**10,809,473,005**	**14,142,845,667**	**62,410,908**	**948,404,015**	**1,183,430,663**	**1,211,535,969**	**65,311,477,157**
Më 31 dhjetor 2021	**37,046,512,391**	**10,579,284,819**	**14,189,609,183**	**59,351,464**	**824,835,358**	**1,145,063,280**	**64,476,508**	**63,909,133,003**

7. Prona, makineri dhe pajisje (vazhdim)

(i) Garancitë

Asnjë prej zërave të pronave, makinerive dhe pajisjeve nuk është lënë kolateral më 31 dhjetor 2021.

(ii) Aktivet në proces

Aktivet në proces përfshijnë kostot e ndërtimit të hidrocentralit të Moglicës. Këto punime janë të lidhura ngushtë me zbatimin e projektit të koncesionit të Devoll Hydropower dhe janë të domosdoshme për përfundimin e këtij projekti.

Ndërtimi i hidrocentralit të Banjës përfundoi gjatë 2016 dhe aktivet e tij u transferuan nga aktivet në proces në kategoritë përkatëse të aktiveve. Ndërtimi i hidrocentralit të Moglicës përfundoi në nëntor 2020. Shoqëria transferoi shumën totale të lidhur me këtë hidrocentral nga aktivet në proces në kategoritë përkatëse të aktiveve.

Shtesat e aktiveve në proces paraqiten si vijon:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	**Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020**
Punime ndërtimi	134,970,044	1,209,265,005
Amortizimi i kapitalizuar	6,407,216	22,444,456
Kosto e punës e kapitalizuar (shih shënimin shpjegues 24)	5,354,913	296,223,012
Totali i shtesave	**146,732,173**	**1,527,932,473**

Punimet e ndërtimit përfshijnë kryesisht kostot e punimeve civile, elektromekanike, punimeve të hidro-mekanike dhe projektimet dhe shërbimet inxhinierike.

(iii) Amortizimi i kapitalizuar

Amortizimi i kapitalizuar i pronave, makinerive dhe pajisjeve dhe amortizimi i aktiveve jo materiale që i përkasin aktiveve në proces janë në vlerën 6,407,216 Lekë (2020: 22,444,456 Lekë). Rakordimi mes shpenzimeve të amortizimit dhe amortizimit të kapitalizuar paraqitet si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	**Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020**
Shpenzimi i amortizimit për vitin (shih shënimet shpjeguese 7, 8)	1,407,237,195	1,107,667,483
Amortizimi dhe zhvlerësimi i kapitalizuar	(6,407,216)	(22,444,456)
Amortizimi i njohur si shpenzim	**1,400,829,979**	**1,085,223,027**

8. Aktivet jo materiale

Aktivet jo materiale janë të përbëra si vijon:

	Programe kompjuterike	Logo, faqe interneti dhe aktive te tjera jo materiale	Totali
Kosto			
Më 1 janar 2020	**61,785,823**	**17,032,728**	**78,818,551**
Shtesa	-	-	-
Nxjerrje jashtë përdorimit	(5,490,339)	-	(5,490,339)
Më 31 dhjetor 2020	**56,295,484**	**17,032,728**	**73,328,212**
Shtesa	840,184	-	840,184
Më 31 dhjetor 2021	**57,135,668**	**17,032,728**	**74,168,396**
Amortizimi i akumuluar			
Më 1 janar, 2020	**38,062,041**	**13,540,761**	**51,602,802**
Amortizimi i vitit	6,243,617	1,406,279	7,649,896
Nxjerrje jashtë përdorimit	(5,672,631)	-	(5,672,631)
Më 31 dhjetor 2020	**38,633,027**	**14,947,040**	**53,580,067**
Amortizimi i vitit	6,233,220	1,167,480	7,400,700
Më 31 dhjetor 2021	**44,866,247**	**16,114,520**	**60,980,767**
Vlera kontabël neto			
Më 1 janar 2020	**23,723,782**	**3,491,967**	**27,215,749**
Më 31 dhjetor 2020	**17,662,457**	**2,085,688**	**19,748,145**
Më 31 dhjetor 2021	**12,269,421**	**918,208**	**13,187,629**

Asnjë prej zërave të aktiveve jo materiale nuk është lënë kolateral më 31 dhjetor 2021.

9. Parapagime

Parapagimet janë të përbëra si vijon:

	Më 31 dhjetor 2021	Më 31 dhjetor 2020
Pjesa afatshkurtër		
Parapagime për nën-kontraktorët	55,242,860	53,622,285
Qira e parapaguar si garanci	515,000	11,166,229
Paradhënie ndaj punonjësve	225,760	225,760
Tatim fitimi i parapaguar	-	105,033
	55,983,620	**65,119,307**
Pjesa afatgjatë		
Garancitë financiare	31,327,795	88,336,969
	31,327,795	**88,336,969**
Totali	**87,311,415**	**153,456,276**

Parapagimet afatshkurtra ndaj nën-kontraktorëve përfaqësojnë punimet civile në hidrocentralin e Moglicës.

Pjesa më e madhe e garancive financiare më 31 Dhjetor 2021, në shumën 27,626,780 leke (2020: 80,120,769 leke), përfaqëson garancinë bankare lidhur me çështjen ligjore të Shoqërisë për apelimin e taksës mbi pronën të vlerësuar nga Bashkia Cërrik (shiko shënimin shpjegues 30).

10. Llogari të arkëtueshme dhe të tjera të arkëtueshme

Llogari të arkëtueshme dhe të tjera të arkëtueshme janë të përbëra si vijon:

	Më 31 dhjetor 2021	Më 31 dhjetor 2020
Të arkëtueshme nga palët e lidhura	2,415,398,154	666,302,259
Të arkëtueshme nga palët e tjera	1,118,044,943	623,431,518
Të tjera të arkëtueshme	8,817,007	10,042,855
TVSH e zbritshme	6,517,973	-
Totali	**3,548,778,077**	**1,299,776,632**

Llogaritë e arkëtueshme nga palët e lidhura përfaqësojnë shumat e pagueshme nga shoqëritë e grupit për shitjen e energjisë dhe shërbimet e lidhura. Të arkëtueshmet nga palët e tjera përfaqëson shumat e pagueshme nga palët e tjera për shitjen e energjisë.

11. Garanci bankare

Garancia bankare më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 në shumën prej 23,000,000 Lekë përfshin fonde të bllokuara në llogarinë bankare të Shoqërisë për një periudhë më të gjatë se tre muaj për Operatorin Shqiptar të Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.) në zbatim të Marrëveshjes për Pjesëmarrje në Tregun e Energjisë Elektrike.

12. Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre janë të përbëra si vijon:

	Më 31 dhjetor 2021	Më 31 dhjetor 2020
Mjete monetare në arkë		
Arka (në Lek)	170,636	402,015
Arka (në EUR)	214,098	219,310
	384,734	**621,325**
Mjete monetare në bankë		
Llogaritë "Escrow" (në Lek)	27,523,120	28,506,704
Llogari rrjedhëse (në Lek)	37,495,529	28,380,203
Llogari rrjedhëse (në EUR)	3,761,310,475	1,015,764,813
	3,826,329,124	**1,072,651,720**
Totali	**3,826,713,858**	**1,073,273,045**

Llogaritë "Escrow" janë hapur me qëllimin për të transferuar pagesat në favor të pronarëve të shpronësuar sipas Akt-Marrëveshjes ndërmjet METE (aktualisht MEI) dhe Devoll Hydropower Sh.A. Kjo marrëveshje kërkon që pronarët të kompensohen për shpronësimin e pronave të tyre nga MEI (fillimisht METE) në bashkëpunim me Devoll Hydropower Sh.A.

13. Kapitali aksionar

Kapitali aksionar i emetuar paraqitet më poshtë:

	2021			2020		
	Numri i Aksioneve	Vlera Nominale	Totali i vlerës së aksioneve	Numri i Aksioneve	Vlera Nominale	Totali i vlerës së aksioneve
Më 1 janar	**86,890**	**1,000,000**	**86,890,000,000**	**86,890**	**1,000,000**	**86,890,000,000**
Kontribute nga aksionari	-	-	-	-	-	-
Më 31 dhjetor i paguar	**86,890**	**1,000,000**	**86,890,000,000**	**86,890**	**1,000,000**	**86,890,000,000**

14. Primi i kapitalit aksionar

Më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 primi i kapitalit të Shoqërisë është 9,690,000 Lekë.

15. Derivativët

Derivativët përbëhen si vijon:

	Më 31 dhjetor 2021	Më 31 dhjetor 2020
Derivativë energjie, aktive afatgjata	-	157,660,177
Derivativë energjie, aktive afatshkurtra	-	78,830,088
Total	-	**236,490,265**
Derivativë energjie, detyrime afatgjata	2,125,845,136	380,419,954
Derivativë energjie, detyrime afatshkurtra	3,700,455,352	190,209,977
Total	**5,826,300,488**	**570,629,931**

16. Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme përbëhen si vijon:

	Më 31 dhjetor 2021	Më 31 dhjetor 2020
Afatshkurtër		
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura	907,193,038	172,746,726
Llogari të pagueshme të tjera	1,986,415	49,596,776
Shumat e mbajtura ndaj nënkontraktorëve	3,026,153	-
Shpenzime të llogaritura	983,940,218	1,085,525,902
	1,896,145,824	**1,307,869,404**
Afatgjatë		
Shumat e mbajtura ndaj nënkontraktorëve	276,645,157	295,657,038
	276,645,157	**295,657,038**
Total	**2,172,790,981**	**1,603,526,442**

Llogaritë e pagueshme ndaj palëve të tjera përfaqësojnë kryesisht shumat për nën-kontraktorët në lidhje me punimet civile të kryera.

Llogaritë e pagueshme ndaj palëve të lidhura përfaqësojnë shumat ndaj shoqërive të grupit në lidhje me blerjet e energjisë dhe shërbimeve të marra nga ata në përputhje me Marrëveshjen për Shërbime dhe Marrëveshjes së Transferimit të Punonjësve.

Shuma të mbajtura nga nën-kontraktorët prej 279,671,310 Lekë me 31 dhjetor 2021 (2020: 295,657,038 Lekë) paraqesin paratë e mbajtura të përllogaritura në bazë të vlerës së çdo certifikate të pagesave në lidhje me punimet civile të kryera nga nën-kontraktorët. Pagesa e shumës së mbajtur nga nën-kontraktorët do të kryhet sapo kushtet e specifikuara në kontratë në lidhje me certifikimin e punimeve të jenë plotësuar.

16. Llogari të pagueshme (vazhdim)

Shpenzimet e përllogaritura përfshijnë shërbimet e kryera nga palët në vijim:

	Më 31 dhjetor 2021	Më 31 dhjetor 2020
Të pagueshme ndaj palëve të lidhura		
Statkraft Markets GmbH	632,468,824	207,617,009
Statkraft Energias Renovaves SA	3,409,173	-
Çakıt Enerji AS	2,825,449	834,768
	638,703,446	**208,451,777**
Të pagueshme ndaj palëve të tjera		
Kurora shpk	121,422,284	-
Osmani shpk	20,328,640	-
Eidikos Logarasmos Kondilion	17,873,822	-
Punime ndërtimi	54,298,524	276,344,706
Kostot e personelit	18,560,883	98,793,526
TI dhe shërbime administrimi	17,965,028	54,132,554
Shërbime teknike	8,453,200	37,411,828
Të tjera	86,334,391	113,074,116
Limak Insaat Sanayie ve Ticaret Anonim	-	212,996,383
Alstom entities (GE)	-	63,008,450
Multiconsult ASA - Dega ne Shqiperi	-	21,312,562
	345,236,772	**877,074,125**
Totali	**983,940,218**	**1,085,525,902**

17. Të tjera të pagueshme

Të tjera të pagueshme përbëhen si vijon:

	Më 31 dhjetor 2021	Më 31 dhjetor 2020
Tatimi në burim	2,989,505	3,788,049
Tatimi mbi të ardhurat personale	2,279,959	12,813,867
Kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	1,823,558	3,625,950
TVSH e pagueshme	-	32,400,494
Detyrime ndaj punonjësve	-	6,328,828
Totali	**7,093,022**	**58,957,188**

18. Të ardhurat

Shoqëria gjeneron te ardhura kryesisht nga shitja e energjisë.

Klienti kryesor

Të ardhurat nga Statkraft Markets GmbH përfaqësojnë afërsisht 7,671,633,613 Lekë (2020: 1,352,149,801 Lekë) të totalit të të ardhurave të Shoqërisë.

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Gjermani	7,671,633,613	1,352,149,801
Shqipëri	1,227,939,555	879,769,242
	8,899,573,168	**2,231,919,043**

19. Humbjet nga aktivitetet e tregut, neto

Humbjet nga aktivitet e tregut, neto përbëhen si vijon:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Fitime të realizuara nga aktivitetet e tregut	1,215,639,643	451,348,272
Humbje të parealizuara nga aktivitetet e tregut	(5,541,201,817)	(185,483,666)
(Humbjet)/fitimet nga aktivitetet e tregut	**(4,325,562,174)**	**265,864,606**

Fitime të realizuara nga aktivitetet e tregut përfaqësojnë të ardhurat nga aktivitetet e tregtisë së energjisë.
Humbje të parealizuara nga aktivitetet e tregut përfaqësojnë ndryshimet në vlerë të drejtë të derivativëve.

20. Të ardhura të tjera/(shpenzime)

Të ardhura të tjera/(shpenzime) detajohen si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Shitja e automjeteve dhe mobiljeve	17,550,585	70,797
VKN e automjeteve dhe mobiljeve të shitura	(8,143,035)	(2,404,748)
Fitim/(humbje) nga shitja e automjeteve dhe mobiljeve	**9,407,550**	**(2,333,951)**

21. Blerje energjie

Blerjet e energjisë detajohen si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Blerje energjie nga palët e lidhura	3,470,919,366	309,113,189
Blerje energjie nga palë të tjera	311,573,950	5,725,518
Totali	**3,782,493,316**	**314,838,707**

22. Blerje kapacitetesh

Blerjet e kapaciteteve detajohen si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Blerje kapacitetesh nga palët e lidhura	506,822,308	738,585,516
Blerje kapacitetesh nga palët e tjera	269,403	6,318,451
Licenca dhe tarifa për tregtimin e energjisë	5,986,469	7,143,122
Totali	**513,078,180**	**752,047,089**

23. Shërbime

Shërbimet detajohen si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Shërbimet nga palët e lidhura	698,224,778	623,186,460
Sigurime	157,641,319	116,878,131
Konsulencë e jashtme	74,232,293	61,821,763
Shërbime sigurimi	49,675,080	43,659,752
Qira	25,215,294	30,842,081
Udhëtime dhe akomodime	3,266,426	4,602,698
Telefon, internet, shërbime postare	2,839,385	3,971,432
Shërbime të tjera	20,030,997	19,038,958
Punime ndërtimi	-	37,338,605
Totali	**1,031,125,572**	**941,339,880**

Pjesa më e madhe e shërbimeve të kryera nga palët e lidhura më 31 dhjetor 2021 përbëhen nga shërbimet e kryera nga Statkraft AS dhe Statkraft Energy AS sipas Marrëveshjes për Shërbime dhe Marrëveshjes së Transferimit të Punonjësve në shumat respektivisht 645,156 mijë Lekë (2020: 515,338 mijë Lekë) dhe 53,068 mijë Lekë (2020: 107,848 mijë Lekë).

24. Kosto personeli

Kostot e personelit detajohen si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Paga	164,734,219	358,784,303
Kontribute për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	13,569,077	22,227,169
Të tjera	6,815,106	8,482,939
Kosto personeli të kapitalizuara	(5,354,913)	(296,223,012)
Totali	**179,763,489**	**93,271,399**

Kostot e kapitalizuara të personelit përfaqësojnë shpenzimet direkte të përfshira në koston e aktiveve të ndërtuara nga vetë Shoqëria. Numri mesatar i punonjësve për vitin e mbyllur 2021 është 46 (2020: 68).

25. Kosto të tjera

Shuma përbëhet si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Shpenzime zyre	14,459,959	13,673,120
Karburant dhe mirëmbajtje makine	14,288,845	10,543,064
Mirëmbajtja e pajisjeve	12,819,908	6,630,800
Blerje materiale të konsumueshme	9,350,919	8,756,407
Shpenzime për mbështetjen e komunitetit	8,590,391	12,999,862
Komisione bankare	2,643,804	3,734,781
Shpenzime reklame	1,469,310	4,620,437
Shpenzime përfaqësimi	26,970	43,573
Gjoba dhe kamatëvonesa	4,469	1,183,344
Shpenzime të tjera	2,586,824	2,264,888
Totali	**66,241,399**	**64,450,276**

Shpenzimet për mbështetjen e komunitetit përfaqësojnë shpenzime të ndryshme të përballuara nga Shoqëria në mbështetje të grupeve të interesit që preken nga projekti i hidrocentraleve.

26. (Humbja)/fitimi nga kurset e këmbimit, neto

Shuma përbëhet si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Fitimi nga kurset e këmbimit	126,320,118	456,579,217
Humbja nga kurset e këmbimit	(201,609,552)	(439,060,799)
(Humbja)/fitimi nga kurset e këmbimit, neto	**(75,289,436)**	**17,518,418**

27. Humbja financiare, neto

Humbja financiare detajohet si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Të ardhura nga interesat	-	14,573
Shpenzime për interesa	(16,660,609)	(6,230,084)
Humbja financiare, neto	**(16,660,609)**	**(6,215,511)**

28. Shpenzimi për tatimin mbi fitimin

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Tatimi mbi fitimin për periudhën	104,659,016	-
Tatimi mbi fitimin i shtyrë	(2,707,785,872)	-
	(2,603,126,856)	**-**

Tatimi mbi fitimin për periudhën

Shoqëria nuk ka kryer ndonjë parapagim për tatimin mbi fitimin gjatë vitit 2021 dhe 2020. Rakordimi midis fitimit tatimor për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 paraqitet si vijon:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Humbja për vitin	**(2,482,063,435)**	**(744,417,773)**
Shpenzime të pazbritshme	5,578,846,087	234,927,390
Amortizim shtesë për qëllime tatimore	(336,028,089)	(295,011,054)
Humbjet e mbartura tatimore	(2,063,027,787)	-
Fitimi/(humbja) tatimore për vitin	**697,726,776**	**(804,501,437)**
Tatimi mbi fitimin @ 15%	104,659,016	-
Humbja tatimore e mbartur për periudhat e ardhshme	**-**	**(804,501,437)**

28. Shpenzimi për tatimin mbi fitimin (vazhdim)

Më poshtë është paraqitur një rakordim i normës efektive të tatimit:

	2021	Norma efektive tatimore	2020	Norma efektive tatimore
Humbja për vitin	**(2,482,063,435)**		**(744,417,773)**	
Tatimi mbi fitimin duke përdorur normën tatimore të	(372,309,515)	15.00%	(111,662,666)	15.00%
Efekti tatimor i:				
Shpenzimeve të pazbritshme	836,826,913	(33.71%)	35,239,108	(4.73%)
Rregullime për amortizimin tatimor	(50,404,213)	2.03%	(44,251,658)	5.94%
Njohja e diferencave të përkohshme të zbritshme të panjohura më parë	(2,207,785,872)	(109.09%)	-	-
Humbjet e mbartura nga vitet e mëparshme	(309,454,169)	12.47%	120,675,216	(16.21%)
Totali i shpenzimit të tatimit mbi fitimin	**(2,603,126,856)**	**104.88%**	**-**	**-**

Shpenzimet e pazbritshme lidhen kryesisht me aktivitetet e tregut dhe shpenzimet e personelit dhe të përfaqësimit.

Tatimi i shtyrë

Më 31 dhjetor 2021 aktive për tatime të shtyra janë njohur në lidhje me zërat e mëposhtme:

2021	Teprica më 1 Janar	Njohur në fitim apo humbje	Aktivet tatimore të shtyra më 31 dhjetor
Dëmtimi i Aktiveve Afatgjata Materiale	-	2,207,785,872	2,207,785,872
Humbje të parealizuara nga aktivitetet e tregut	-	500,000,000	500,000,000
	-	**2,707,785,872**	**2,707,785,872**

Sipas legjislacionit tatimor aktual diferencat e zbritshme të përkohshme nuk skadojnë. Diferencat e zbritshme të përkohshme vijnë nga zëri i pronave, makinerive dhe pajisjeve dhe lidhen me diferencën në kohë të njohjes së zhvlerësimit për qëllime tatimore. Zhvlerësimi i njohur si shpenzim i pazbritshëm në PF 2016, do të njihet për qëllime tatimore përgjatë jetës së dobishme të aktiveve nëpërmjet shpenzimit të amortizimit të llogaritur mbi vlerën e aktiveve pa përfshirë humbjen nga zhvlerësimi. Drejtimi ka rishikuar përllogaritjet e fitimeve të ardhshme tatimore dhe Shoqëria ka njohur efektin tatimor prej 14,7 miliardë lekë nga dëmtimi i aktiveve afatgjata materiale, pasi drejtimi e ka vlerësuar të mundshme se në të ardhmen do të ketë fitime të tatueshme të cilat do të mund të përdoren për të mbuluar këto humbje.

Humbjet e parealizuara nga aktivitetet e tregut lidhen me diferencën kohore në njohjen për qëllime tatimore të rezultatit në fund të vitit të kontratave të klasifikuara si derivativë matur me vlerën e drejtë përmes fitimit dhe humbjes. Humbjet e parealizuara nga aktivitetet e tregut do të njihen për qëllime tatimore në datën e ushtrimit të kontratës, kur Shoqëria ta ushtrojë fizikisht atë nëpërmjet shitjes së energjisë në këmbim.

28. Shpenzimi për tatimin mbi fitimin (vazhdim)

Tatimi i shtyrë (vazhdim)

Më 31 dhjetor 2020 aktive për tatime të shtyra janë vlerësuar nga drejtimi por nuk janë njohur për sa i përket zërave të mëposhtëm:

	2021		2020	
	Vlera bruto	**Efekti tatimor**	**Vlera bruto**	**Efekti tatimor**
Humbjet tatimore nga 2017	-	-	-	-
Humbjet tatimore nga 2018	-	-	(561,944,546)	(84,291,682)
Humbjet tatimore nga 2019	-	-	(696,581,804)	(104,487,271)
Humbjet tatimore nga 2020	-	-	(804,501,437)	(120,675,216)
Totali i humbjeve tatimore	-	-	*(2,063,027,787)*	*(309,454,169)*
Diferencat e përkohshme të zbritshme	-	-	(12,746,689,225)	(1,912,003,384)
Totali	**-**	**-**	**(14,809,717,012)**	**(2,221,457,553)**

Humbjet tatimore mund të mbarten deri në 3 vjet. Më 31 dhjetor 2020 nuk janë njohur aktive për tatime të shtyra në lidhje me këto zëra për shkak të pasigurive në lidhje më kohën se kur fitimi i ardhshëm i tatueshëm do të jetë i mjaftueshëm për të përdorur përfitimet përkatëse.

29. Palët e lidhura

Shoqëria ka marrëdhënie si palë e lidhur me shoqërinë mëmë, kompanitë e tjera të grupit dhe drejtuesit kryesorë. Një përmbledhje e tepricave me palët e lidhura paraqitet si më poshtë:

Të drejta nga palët e lidhura	**Më 31 dhjetor 2021**	**Më 31 dhjetor 2020**
Statkraft Markets GmbH	2,406,090,721	658,738,727
Statkraft Energi AS	4,064,390	-
Statkraft Enerji AS	3,984,627	4,081,661
Statkraft Renewables Albania Shpk	1,258,416	3,222,632
Statkraft UK Ltd	-	259,239
Totali (shih shënimin shpjegues 10)	**2,415,398,154**	**666,302,259**

	Më 31 dhjetor 2021	**Më 31 dhjetor 2020**
Detyrime ndaj palëve të lidhura		
Statkraft Markets GmbH	1,490,990,345	315,524,595
Statkraft AS	41,192,157	46,352,348
Statkraft Energi AS	3,538,389	8,296,485
Statkraft Energias Renováveis SA	3,409,173	-
Çakıt Enerji A.Ş	2,825,449	834,768
Statkraft Enerji A.S.	2,113,300	6,826,454
Statkraft Energy Ltd	1,347,517	2,835,864
Himal Power Ltd	425,829	403,046
Statkraft Sverige AB	54,325	96,946
Statkraft India Private Ltd.	-	27,997
Totali	**1,545,896,484**	**381,198,503**

29. Palët e lidhura (vazhdim)

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Transaksione me palë të lidhura		
Kapitalizuar si aktive në proces	***22,172,080***	***100,828,656***
Stakraft Enerji A.S.	11,627,255	23,207,951
Statkraft AS	4,287,265	74,105,960
Statkraft Energias Renovaves SA	3,409,173	-
Statkraft Energi AS	1,826,155	1,820,594
Statkraft UK Ltd	1,022,232	-
Statkraft India Pvt. Ltd.	-	1,694,151

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Të ardhurat	***6,297,334,280***	***2,295,736,724***
Statkraft Markets GmbH	6,270,510,304	2,275,345,351
Statkraft Enerji	16,106,435	16,588,889
Statkraft Renewables Albania Shpk	6,379,831	2,689,522
Statkraft Energi AS	4,337,710	-
Empresa Electrica Pilmaiq	-	1,112,962

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Fitime nga aktivitetet e tregut (shiko shënimin shpjegues 19)	***1,401,123,309***	***451,348,272***
Statkraft Markets GmbH	1,401,123,309	451,348,272

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Shpenzimet	***5,038,795,889***	***2,685,562,479***
Statkraft Markets GmbH	4,483,457,304	2,201,624,149
Statkraft AS	483,092,892	408,116,882
Statkraft Energi AS	25,468,741	41,607,265
Statkraft Energy Ltd	16,536,760	18,184,083
Çakıt Enerji A.Ş	11,317,922	834,768
Statkraft Holding Singapore Pt	2,495,970	-
Stakraft Enerji A.S.	1,878,129	-
Statkraft Renewables Albania Shpk	1,705,996	-
Statkraft Sverige AB	763,369	1,721,648
Statkraft India Private Ltd.	131,640	1,636,618
Statkraft Ireland Ltd.	31,303	-
Statkraft Markets B.V.	-	1,434,234
Tidong Power Gen Pvt Ltd	-	617,743
Statkraft UK Ltd	-	261,348
Key management compensation	11,915,863	9,523,741

Aksionari i vetëm i Shoqërisë është Statkraft Markets B.V dhe shoqëria mëmë dhe filialet e saj janë e vetmja palë e lidhur. Pala kontrolluese përfundimtare e Shoqërisë është Statkraft A.S.

Të gjitha tepricat e papaguara ndaj palëve të lidhura janë çmuar duke u bazuar në parimin e tregut dhe duhet të paguhen brenda tre muajve nga data e raportimit. Asnjë prej shumave nuk është e siguruar. Nuk është marrë ose dhënë asnjë garanci.

30. Instrumentet financiare

(a) Përcaktimi i vlerës së drejtë

Vlera e drejte e aktiveve financiare dhe detyrimeve financiare te matura me koston e amortizuar konsiderohet të jetë afërsisht sa vlera e tyre kontabël (neto) për shkak të natyrës së tyre afatshkurtër.

Matja e derivativëve me vlerë të drejtë në datën e raportimit, është e bazuar në transaksionet e Grupit të kryera në sistemin e tregtimit Murex dhe bazuar në çmimet nga bursa e energjisë Hupex. Pra, vlera e drejtë e derivativëve është përcaktuar nga burimet e nivelit të dytë.

(b) Administrimi i rrezikut financiar

Shoqëria është e ekspozuar ndaj rreziqeve të mëposhtme nga përdorimi i instrumenteve financiare:

- rreziku kreditor
- rreziku i likuiditetit
- rreziku i tregut

(i) Kuadri i administrimit të rrezikut

Bordi i drejtorëve të shoqërisë ka përgjegjësinë e përgjithshme për hartimin dhe mbikëqyrjen e kuadrit të administrimit të rrezikut të Shoqërisë.

Politikat e administrimit të rrezikut të Shoqërisë janë hartuar për të identifikuar dhe analizuar rreziqet e hasura nga Shoqëria, për të vendosur kontrollet dhe limitet e duhura të rrezikut dhe për të monitoruar rrezikun dhe respektimin e limiteve. Politikat dhe sistemet e administrimit të rrezikut rishikohen rregullisht për të reflektuar ndryshimet në kushtet e tregut dhe aktivitetet e Shoqërisë. Shoqëria, nëpërmjet standardeve dhe procedurave të saj të trajnimit dhe drejtimit synon të mbajë një mjedis të disiplinuar dhe konstruktiv të kontrollit në të cilin të gjithë punonjësit janë në dijeni për rolet dhe detyrimet e tyre.

Ky shënim shpjegues paraqet informacionin rreth ekspozimit të Shoqërisë ndaj secilit prej rreziqeve të mësipërme, objektivave të Shoqërisë, politikave dhe proceseve për matjen dhe administrimin e rrezikut dhe administrimin e kapitalit të Shoqërisë. Shënime shpjeguese sasiore të tjera janë përfshirë përgjatë këtyre pasqyrave financiare.

(ii) Rreziku kreditor

Rreziku kreditor është rreziku i një humbje financiare nga Shoqëria në rast se një klient apo një palë në një instrument financiar nuk përmbush detyrimet kontraktuale dhe krijohet kryesisht nga llogaritë e arkëtueshme të Shoqërisë.

Shuma e mbartur e aktiveve financiare përfaqëson maksimumin e ekspozimit ndaj rrezikut të kreditit.

Llogaritë e arkëtueshme

Ekspozimi i Shoqërisë ndaj rrezikut kreditor është influencuar kryesisht nga karakteristikat individuale të secilit klient. Megjithatë, drejtimi merr gjithashtu në konsideratë edhe faktorët që mund të influencojnë rrezikun kreditor të tyre si konsumatorë, duke përfshirë rrezikun e falimentimit të shoqëruar me rrezikun e industrisë dhe vendit në të cilin veprojnë klientët. Detajet e përqendrimit të të ardhurave janë përfshirë në Shënimin shpjegues 18.

Kufizimet për kontratat e energjisë, janë përcaktuar individualisht për palën tjetër duke përdorur një vlerësim të brendshëm të kreditit. Palët janë ndarë sipas kategorive të ndryshme. Vlerësimi i brendshëm i kreditit është bazuar në të dhënat financiare të rëndësishme (modeli i vlerësimit i kryer nga Shoqëria/opinioni i ekspertit), vlerësimet e jashtme dhe probabilitetet e mos-arkëtimit të blera nga ofrues te jashtëm.

Kontratat dypalëshe janë subjekt i kufizimeve për çdo palë tjetër për sa i përket vëllimit, sasisë dhe kohëzgjatjes. Rreziku për palën tjetër nga këto kontrata konsiderohet të jetë shumë i ulët.

Kufijtë e ekspozimit individual të çdo pale tjetër monitorohen vazhdimisht dhe i raportohen rregullisht drejtimit. Shoqëria kufizon ekspozimin e saj ndaj rrezikut të kreditit nga llogaritë e arkëtueshme tregtare, duke vendosur një periudhë maksimale të pagesës nga një deri në tre muaj respektivisht për palët e lidhura dhe klientët e palëve të tjera. Kufijtë e kreditit mund të ulen duke pranuar mbështetjen e kreditit në formën e një garancie nga Shoqëria mëmë dhe/ose garanci bankare.

30. Instrumentet financiare (vazhdim)

(b) Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(ii) Rreziku kreditor (vazhdim)

Shoqëria kufizon ekspozimin e saj ndaj rrezikut të kreditimit nga llogaritë e arkëtueshme duke vendosur një afat maksimal për kryerjen e pagesave, qe është gjashtë muaj për klientët e zakonshëm dhe një muaj për korporatat.

Pothuajse të gjithë klientët e Shoqërisë kryejnë transaksione me Shoqërinë prej katër vitesh, që nga fillimi i aktivitetit të saj dhe asnjë balancë e këtyre klientëve nuk është çregjistruar ose zhvlerësuar në datën e raportimit. Në monitorimin e rrezikut të kreditimit për klientët, ato janë grupuar sipas karakteristikave të detyrimeve të tyre, ku përfshihet nëse janë palë të lidhura, klientë të tjerë, rajonet e tyre gjeografike, historiku i tregtisë me Shoqërinë dhe prania e vështirësive te mëparshme financiare. Më 31 dhjetor 2021, ekspozimi maksimal i llogarive të arkëtueshme ndaj rrezikut të kreditit sipas rajoneve gjeografike, paraqitet si më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2021	**Më 31 dhjetor 2020**
Gjermani	2,406,090,721	658,738,726
Shqipëri	983,861,358	626,654,151
Zvicër	135,442,001	-
Norvegji	4,064,390	-
Turqi	3,984,627	4,081,661
Mbretëria e Bashkuar	-	259,239
	3,533,443,097	**1,289,733,777**

Më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 ekspozimi maksimal i llogarive të arkëtueshme ndaj rrezikut të kreditit sipas palëve paraqitet si më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2021	**Më 31 dhjetor 2020**
Palët e lidhura	2,415,398,154	666,302,259
Palët e tjera	1,118,044,943	623,431,518
	3,533,443,097	**1,289,733,777**

Më 31 dhjetor 2021 klienti më i rëndësishëm i Shoqërisë, Statkraft Markets GmbH, përbën 67.68% të vlerës së mbartur të llogarive të arkëtueshme (2020: 50%).

Vlerësimi për humbjen e pritshme të kredisë për klientët korporata

Asnjë nga llogaritë e arkëtueshme të Shoqërisë nuk është në vonesë dhe rreziku i tyre i kreditimit nuk është rritur në mënyrë të konsiderueshme nga njohja fillestare. Rrjedhimisht, humbja e lejuar mund të matet me vlerën e humbjeve të pritshme të kredisë për 12 muaj.

Norma historike e humbjes për llogaritë e arkëtueshme të Shoqërisë është 0%. Norma e parashikuar e humbjes është llogaritur të jetë afërsisht 0% për shkak të rrezikut minimal të mospagimit nga ana e shoqërive me të cilat Shoqëria tregton, të cilat përfshijnë shoqëritë brenda grupit dhe entitete publike. Si rezultat, Shoqëria ka llogaritur që vlera e humbjeve të pritshme të kredisë për 12 muajt në lidhje me llogaritë e saj të arkëtueshme nuk është materiale për këto pasqyra financiare.

Mjetet monetare dhe ekuivalentet me to

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre mbahen në bankë dhe institucione financiare të cilat janë të klasifikuara si Baa2 deri në Baa3, bazuar në vlerësimet e Moody's.

Teprica e mjeteve monetare sipas vlerësimeve të Moody's paraqitet si më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2021	**Më 31 dhjetor 2020**
Baa2	3,826,329,124	988,179,857
Baa3	-	84,471,863
	3,826,329,124	**1,072,651,720**

30. Instrumentet financiare (vazhdim)

(b) Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(iii) Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku që Shoqëria të hasë vështirësi në përmbushjen e detyrimeve të lidhura me detyrimet financiare të saj të cilat shlyhen me anë të mjeteve monetare apo të ndonjë aktivi tjetër financiar. Qëllimi i Shoqërisë në administrimin e likuiditetit është që të sigurojë, aq sa është e mundur, se ajo gjithmonë do të ketë likuiditetin e mjaftueshëm për përmbushjen e detyrimeve në kohë, si në kushtet normale ashtu edhe në vështirësi, pa pasur humbje të papranueshme apo pa rrezikuar dëmtimin e reputacionit të Shoqërisë.

Shoqëria synon që të sigurojë mbajtjen e likuiditetit të mjaftueshëm për të përmbushur detyrimet e saj brenda 6 muajve të ardhshëm. Më poshtë janë paraqitur afatet kontraktuale të detyrimeve financiare më 31 dhjetor 2021 dhe 2020. Shumat janë neto dhe të pa skontuara, meqenëse diferenca mes skontimit dhe mos skontimit nuk është materiale.

		Flukset kontraktuale të parasë			
31 dhjetor 2021	**Vlera kontabël**	**Deri në 6 muaj**	**6-12 muaj**	**1-5 vjet**	**Mbi 5 vite**
Llogari të pagueshme	1,893,119,671	1,893,119,671	-	-	-
Të tjera të pagueshme	7,093,022	7,093,022	-	-	-
Shuma të mbajtura ndaj nën-kontraktorëve	279,671,310	-	3,026,153	276,645,157	-
Totali	**2,179,884,003**	**1,900,212,693**	**3,026,153**	**276,645,157**	**-**

		Flukset kontraktuale të parasë			
31 dhjetor 2020	**Vlera kontabël**	**Deri në 6 muaj**	**6-12 muaj**	**1-5 vjet**	**Mbi 5 vite**
Llogari të pagueshme	1,307,869,404	1,307,869,404	-	-	-
Të tjera të pagueshme	58,957,188	58,957,188	-	-	-
Shuma të mbajtura ndaj nën-kontraktorëve	295,657,038	-	-	295,657,038	-
Totali	**1,662,483,630**	**1,366,826,592**	**-**	**295,657,038**	-

(iv) Rreziku i tregut

Rreziku i tregut është rreziku i ndryshimit të çmimeve të tregut, të tilla si çmimi i energjisë elektrike, normat e interesit, normat e këmbimit dhe çmimet e kapitalit që do të ndikojnë në të ardhurat e Shoqërisë ose vlerën e instrumenteve financiare të zotëruara. Objektivi i administrimit të rrezikut të tregut është të administrojë dhe kontrollojë ekspozimin ndaj rrezikut të tregut brenda parametrave të pranueshëm duke maksimizuar kthimin.

Rreziku i çmimit të tregut

Si një prodhues energjie, Shoqëria është e ekspozuar ndaj rrezikut të tregut të lidhur me çmimin e energjisë. Brenda tregtimit të energjisë, shoqëria zotëron portofole që reduktojnë rrezikun e tregut, si dhe portofolet brenda rregullave të vendosura, ku Shoqëria pranon një shkallë të rrezikut të tregut në mënyrë që të gjenerojnë fitim. Administrimi i rrezikut në tregtimin e energjisë fokusohet në totalin e portofoleve dhe jo kontratave individuale. Udhëzimet e brendshme që kontrollojnë nivelin e ekspozimit të tregut janë krijuar për të gjitha portofolet. Rregulloret për tregtimin sipas të dy kontratave, fizike apo financiare, monitorohen vazhdimisht.

Rreziku i kursit të këmbimit

Shoqëria është e ekspozuar ndaj rrezikut të kursit të këmbimit lidhur me ndryshimet e mundshme në normat e kurseve të këmbimit për sa i përket transaksioneve të saj në monedhë të huaj. Shoqëria disponon teprica të konsiderueshme në Euro si detyrim ndaj furnitorëve të saj, gjë që ekspozon Shoqërinë ndaj rrezikut të kursit të këmbimit. Shoqëria disponon teprica të konsiderueshme në Euro të mjeteve monetare dhe ekuivalentet e tyre që maturohen në të njëjtën periudhë në të cilën detyrimet tregtare duhet të shlyhen.

30. Instrumentet financiare (vazhdim)

(b) Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(iv) Rreziku i tregut

Ekspozimi ndaj rrezikut të kursit të këmbimit

Ekspozimi i Shoqërisë ndaj rrezikut të kursit të këmbimit më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 ishte si vijon:

Më 31 dhjetor 2021	Vlera kontabël	Euro (përkthyer në Lek)	Të tjera (përkthyer në Lek)	Lek
Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre	3,826,713,858	3,761,524,573	-	65,189,285
Garanci bankare	23,000,000	-	-	23,000,000
Llogari të arkëtueshme dhe të tjera të arkëtueshme	3,548,778,077	3,542,263,466	-	6,514,611
Llogari të pagueshme	(1,893,119,671)	(1,817,936,306)	(75,054,722)	(128,643)
Të tjera të pagueshme	(7,093,022)	-	-	(7,093,022)
Shuma të mbajtura ndaj nën-kontraktorëve	(279,671,310)	(274,310,129)	-	(5,361,181)
Ekspozimi neto	**5,218,607,932**	**5,211,541,604**	**(75,054,722)**	**82,121,050**

Më 31 dhjetor 2020	Vlera kontabël	Euro (përkthyer në Lek)	Të tjera (përkthyer në Lek)	Lek
Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre	1,073,273,045	1,015,984,123	-	57,288,922
Garanci bankare	23,000,000	-	-	23,000,000
Llogari të arkëtueshme dhe të tjera të arkëtueshme	1,299,776,632	1,284,916,309	-	14,860,323
Llogari të pagueshme	(1,307,869,404)	(1,237,743,086)	(43,368,023)	(26,758,295)
Të tjera të pagueshme	(58,957,188)	(26,218,848)	(4,572,296)	(28,166,044)
Shuma të mbajtura ndaj nën-kontraktorëve	(295,657,038)	(295,657,038)	-	-
Ekspozimi neto	**733,566,047**	**741,281,460**	**(47,940,319)**	**40,224,906**

Gjatë vitit janë aplikuar normat e mëposhtme të kursit të këmbimit:

	Norma mesatare		Norma në datën e raportimit	
	2021	**2020**	**2021**	**2020**
Lekë/Euro	122.45	123.77	120.76	123.70

Analiza e ndjeshmërisë ndaj kursit të këmbimit

Në administrimin e rrezikut të kursit të këmbimit Shoqëria ka për qëllim të zvogëlojë ndikimin e luhatjeve afatshkurtra në fitimet e Shoqërisë. Megjithatë, në periudhën afatgjatë, ndryshimet e përhershme në normat e kurseve të këmbimit mund të kenë ndikim në fitim. Një analizë e ndikimit të vlerësuar të ndryshimeve në përqindjen e luhatjeve të vlerës së Lekut ndaj monedhave të huaja është paraqitur më poshtë.

Analiza e ndjeshmërisë së mëposhtme është zhvilluar duke u bazuar në ekspozimin ndaj kursit të këmbimit në datën e raportimit dhe ndryshimit të përcaktuar i cili ndodh në fillim të vitit financiar dhe mbahet konstant gjatë gjithë periudhës raportuese.

31. Instrumentet financiare (vazhdim)

(b) Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(iv) Rreziku i tregut (vazhdim)

Më poshtë paraqitet analiza e efekteve të ndryshimeve të kursit të këmbimit në fitimin apo humbjen dhe kapitalit neto mbas tatimit, duke supozuar se të gjithë faktorët e tjerë në veçanti normat e interesit, janë konstante:

	2021	2020
EUR zhvlerësohet me 10%	(521,154,160)	(74,128,146)
EUR vlerësohet me 10%	521,154,160	74,128,146

Rreziku i normave të interesit

Shoqëria nuk përballet me ndonjë rrezik të rëndësishëm të normave të interesit të flukseve monetare sepse ajo nuk disponon detyrime financiare të cilat gjenerojnë interesa.

Analiza e ndjeshmërisë së vlerës së drejtë për instrumentet me normë fikse

Shoqëria nuk ka ndonjë aktiv financiar dhe detyrim financiar me normë fikse te matur me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, dhe Shoqëria nuk cakton derivatet (këmbime të normës së interesit) si instrumente mbrojtëse sipas modelit të kontabilitetit mbrojtës me vlerë të drejtë. Prandaj, një ndryshim në normat e interesit në datën e raportimit nuk do të ndikojë në fitimin ose humbjen.

Administrimi i kapitalit

Politika e Shoqërisë është të ruajë një bazë të fortë kapitali, me qëllim që të ruajë besueshmërinë e investitorëve, kreditorëve dhe të tregut dhe të ruajë zhvillimet e ardhshme të biznesit. Nuk ka pasur ndryshime në metodën e Shoqërisë në lidhje me administrimin e kapitalit gjatë vitit. Shoqëria nuk është subjekt i kërkesave të jashtme mbikëqyrëse në lidhje me kapitalin.

32. Angazhime dhe detyrime të ardhshme

Angazhime për qiranë operative

Me 31 dhjetor 2021 Shoqëria ishte palë në 5 (2020: 6) kontrata qiraje të zakonshme në lidhje me qiranë e zyrave në Tiranë dhe magazinave në Gramsh, hapësira parkimi dhe apartamente. Pagesat e ardhshme minimale të qirasë në bazë të kontratave kryesore janë si vijon:

	2021	2020
Brenda një viti	4,848,617	5,824,089
	4,848,617	**5,824,089**

Shpenzimet e qirasë bazuar në marrëveshjen e qirasë për zyrën në Tiranë dhe apartamentet në Tiranë dhe Gramsh për vitet që mbarojnë më 31 dhjetor 2021 dhe 2020, ishin përkatësisht 25,157,963 Lekë dhe 30,650,586 Lekë dhe janë përfshirë në pasqyrën shoqëruese të fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse.

Shpenzimet e qirasë bazuar në marrëveshjen e qirasë në Tiranë dhe Gramsh për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2021 ishin 25,175,963 Lekë (2020: 13,284,918 Lekë) dhe janë përfshirë në pasqyrën shoqëruese të pozicionit financiar.

Garancia e Kontratës

Duke iu referuar pikës 7.3.14 të Marrëveshjes Koncesionare, Koncesionari i ka paraqitur Autoritetit Kontraktues "METE" (aktualisht MEI) një Garanci Kontrate.

Garancia e Kontratës me vlerë fillestare 50 milion Euro i është dhënë Autoritetit Kontraktues në datën e nënshkrimit të Marrëveshjes së Koncesionit dhe në çdo rinovimi të mëpasshëm te garancisë së kontratës çdo vit, siç përshkruhet në Nenin 7.3.14 (b) të Marrëveshjes së Koncesionit.

31. Angazhime dhe detyrime të ardhshme (vazhdim)

Garancia e Kontratës (vazhdim)

Autoriteti Kontraktues bie dakord se shuma fillestare e Kontratës së Sigurisë do të reduktohet me:

- 16 milion Euro pas lëshimit të Certifikatës së Përfundimit Final të Hidrocentralit të Banjës (minus shumat e tërhequra deri në atë kohë për pretendimet lidhur me Hidrocentralin e Banjës)
- 28 milion Euro pas lëshimit të Certifikatës së Përfundimit Final të Hidrocentralit të Moglicës (minus shumat e tërhequra deri në atë kohë për pretendimet lidhur me Hidrocentralin e Moglicës)

Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të tërheqë Garancinë e Kontratës për çdo dëm të likuidimit sipas pikës 7.3.11 (a) të Marrëveshjes së Koncesionit, nëse Koncesionari dështon të paguajë shuma të tilla brenda afateve të specifikuara në seksionin 7.2.5 të Marrëveshjes së Koncesionit.

Nga data efektive e Shtojcës së 3-të, Koncesionari ka ofruar një garanci kontrate për Autoritetin Kontraktues në vlerën prej 44 milion Euro dhe për çdo rinovim të mëtejshëm të garancisë së kontratës, e cila do të jetë e vlefshme për një periudhë minimale prej një viti.

Nga data 1 shkurt 2018 garancia është 28 milion Euro pasi është marrë dhe certifikata përfundimtare e ndërtimit te hidrocentralit të Banjës.

Më 17 nëntor 2020 Autoriteti Kontraktues lëshoi Çertifikatën e Përfundimit Final për Hidrocentralin e Moglicës. Kjo do të thotë qe DHP nuk është i detyruar për të dhënë Garancinë e Kontratës Autoritetit Kontraktues.

Rritjet e taksës (rritja e taksës së koncesionarit dhe kontraktorëve te tij) sipas Marrëveshjes Koncesionare

Në cilësinë e Koncesionarit dhe në përputhje me artikullin 2.4.3 dhe 2.4.5 të Marrëveshjes Koncesionare shoqëria ka një shumë për tu arkëtuar nga METE (aktualisht MEI) për vitet 2015 – 2018 si pasojë e ndryshimit në legjislacionin tatimor.

Angazhimet për kapitalin sipas Marrëveshjes Koncesionare

Bazuar në Marrëveshjen Koncesionare të nënshkruar midis Koncesionarit dhe METE (aktualisht MEI), koncesionari është përgjegjës për planifikimin, financimin, ndërtimin, pronësinë, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e projektit hidroenergjetik mbi lumin Devoll.

Angazhimet që rrjedhin nga shpronësimet e pasurive të paluajtshme

Nga viti 2012, Këshilli i Ministrave vendosi për shpronësimin e disa pronarëve të pasurive të paluajtshme që preken nga ndërtimi i projektit hidroenergjetik mbi lumin Devoll.

Pronat që janë subjekt i shpronësimit do të kalojnë në favor të autoriteteve përkatëse si Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikes (METE - aktualisht MEI), Autoriteti Shqiptar i Rrugëve, dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes të cilët më pas do t'i transferojnë Shoqërisë të drejtën e përdorimit të pronave. Angazhimet në vlerën prej 53,693,231 Lekë lidhur me shpronësimet janë detyrime për t'u shlyer në të ardhmen.

Kjo shumë vjen si rezultat i Vendimeve të Këshillit të Ministrave (VKM) lidhur me shpronësimet, si më poshtë:

VKM Nr.	Data	Përshkrimi	Shuma për t'u paguar
656	26.09.2012	Për shpronësimin e hidrocentraleve të Banjës, Kokel dhe Moglice	32,850,617
860	21.10.2015	Ndryshim i VKM së mësipërme	7,120,380
661	07.08.2013	Për 110 dhe 220 kV	1,015,502
674	15.10.2014	Për shpronësimin nga Loti 2 dhe 3	2,240,786
285	13.04.2016	Shpronësim i rrugës Banjë-Gramsh	2,029,997
463	26.07.2018	M03 Zëvendësimi i rrugës Moglicë	3,436,926
461	10.06.2020	Ndryshimi i 110 dhe 220kV TL	3,503,032
25	15.01.2020	Për shpronësimin e rrugës përgjatë bregut jugor të rezervuarit të Banjës	1,495,991
		Totali	**53,693,231**

31. Angazhime dhe detyrime të ardhshme (vazhdim)

Detyrime të kushtëzuara dhe procedura ligjore

Shoqëria ka depozituar më 25.02.2021 një kërkesë për apelim administrativ në Bashkinë Cerrik në lidhje me vlerësimin e taksave lokale nga kjo e fundit. Si një kërkesë ligjore, Shoqëria ka lënë peng shumën 17,776,178 Lekë si një garanci bankare. Apelimi nuk u pranua nga Kryetari i Bashkisë dhe rrjedhimisht DHP nisi një padi ligjore në gjykatën administrative përgjegjëse brenda afatit të parashikuar me ligj. Bazuar në përfaqësimin e shkruar të marrë nga këshilltari ligjor i ngarkuar me procedimin e mësipërm, është e mundur që vendimi për këtë çështje të jetë në favor të DHP.

Shoqëria ka depozituar më 29.10.2021 një kërkesë për apelim administrativ në Bashkinë Gramsh në lidhje me vlerësimin e taksave lokale nga kjo e fundit. Shoqëria ka lënë peng shumën 9,850,000 Lekë si garanci bankare. Për këtë apelim nuk u mor asnjë përgjigje nga Kryetari i Bashkisë dhe rrjedhimisht DHP nisi një padi ligjore në gjykatën administrative përgjegjëse brenda afatit të parashikuar me ligj pas përfundimit të afatit brenda të cilit Kryetari i Bashkisë duhet të merrte vendimin. Bazuar në përfaqësimin e shkruar të marrë nga këshilltari ligjor i ngarkuar me procedimin e mësipërm, është e mundur që vendimi për këtë çështje të jetë në favor të DHP.

Përveç sa më sipër, Shoqëria nuk është subjekt i ndonjë procedure tjetër ligjore, ankimi ose çështje gjyqësore gjatë rrjedhës normale të biznesit.

32. Ngjarje mbas datës së raportimit financiar

Operacioni ushtarak që është duke ndodhur në Ukrainë dhe sanksionet e vëna kundrejt Federatës Ruse mund të kenë ndikim në ekonomitë Europiane dhe globale. Shoqëria nuk është direkt e ekspozuar me Ukrainën, Rusinë apo Bjellorusinë. Sidoqoftë, ndikimi në situatën e përgjithshme ekonomike mund të kërkojë rishikimin e disa supozimeve apo përllogaritjeve. Kjo mund të rezultojë në ndryshime materiale të vlerës kontabël të disa aktiveve dhe detyrimeve në të ardhmen. Në këtë fazë, manaxhimi nuk mund të masë në mënyre të besueshme ndikimin pasi ngjarje të reja zhvillohen ditë pas dite. Ndikimi më afatgjatë do të nevojitej të matej në mënyrë të vazhdueshme nëpërmjet volumit të tregtisë, flukset monetare dhe përfitimit. Megjithatë, në datën e pasqyrave financiare Shoqëria vijon të përmbushë detyrimet e saj në maturim dhe si pasojë vijon të përgatisë pasqyrat në bazë të parimit të vijimësisë.

Manaxhimi e ka konsideruar ngjarjen e mësipërme si një ngjarje që nuk kërkon rregullim në pasqyra financiare.

Nuk ka ngjarje të tjera pas datës së raportimit financiar që mund të kërkojnë veprime rregulluese apo shpalosje, përveçse sa më lart.